



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA  
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
*Qeveria-Vlada-Government*



**SEKRETARIATI - KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK TË KOSOVËS**

**PROCESVERBAL**

**Takim virtual me Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe Bankës Qendrore të Kosovës**

**Prishtinë, 16 prill 2020**

Takim virtual  
Prishtinë

Mbështetur nga:



## FTESË

### FTESË - TAKIM VIRTUAL ME MINISTRIN E FINANCAVE DHE TRANSFEREVE DHE GUVERNATORIN E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

Të nderuar anëtarë,

Sekretariati i KKZHE-së nesër me datë **16 prill 2020** në ora **10:00 - 12:00**, ka organizuar një takim virtual me Ministrin e Financave dhe Transferëve, z.Besnik Bislimi dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, z.Fehmi Mehmeti.

Bashkangjitur mund të gjeni dhe agjendën e takimit.

Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në këtë takim virtual deri nesër në ora 8:00 në mënyrë që të ju përcjellim link-un për qasje në platformë.

Nëse keni pyetje apo rekomandime për indikatorët makroekonomik, ju lutemi të na i dërgoni paraprakisht në mënyrë që takimi të jetë sa më praktik dhe konstruktiv.

*Shënim: Diskutimi do të zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe.*

Duke pasur parasysh që gjatë kësaj kohe të jazhtëzakonshme puna po zhvillohet me një ritëm tjetër, shpresojmë të kemi mirëkuptimin tuaj për njoftim në afat kaq të shkurtër.

Me respekt,

Sekretariati i KKZHE-së

**FTESË - TAKIM VIRTUAL ME MINISTRIN E FINANCAVE DHE TRANSFEREVE DHE GUVERNATORIN E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS**

Të nderuar anëtarë,

Faleminderit që keni konfirmuar pjesëmarrjen në takimin që do të mbahet në formë virtuale nëpërmes BlueJeans.

Për qasje në takimin që mbahet nesër, **16 prill 2020** nga ora **10:00** gjeni detajet si në vijim:

**Linku i takimit:** <https://bluejeans.com/4360852965/1604>

**Meeting ID:** 436 085 296 5

**Passcode:** 1604

*Shënime:*

- Ju lutemi që të qaseni në takim në ora **9:45**
- *Qasjen në takim mund ta bëni përmes broëser-it, pa pasur nevojë që të shkarkoni aplikacionin e BlueJeans.*

Në agjendë janë rezervuar 45 min për anëtarët që të prezantojnë apo diskutojnë temat që ndërlidhen me Ministrinë e Financave dhe Transferëve.

Poashtu, bashkangjitur me këtë e-mail po ju përcjellim agjenden si dhe analizën “Segmentet kryesore të ndikimit ekonomik të pandemisë Covid-19” të punuar nga Sekretariati i KKZHE-së të cilin do ta prezantojmë nesër gjatë takimit.

Me respekt,  
Sekretariati i KKZHE-së



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA  
Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës  
Sekretariati i KKZHE-së**

**TAKIM VIRTUAL ME MINISTRIN E FINANCAVE DHE TRANSFEREVE DHE  
GUVERNATORIN E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS**

**E enjte, 16 prill 2020, ora 10:00 – 12:00  
Prishtinë**

## **Agjenda**

- 10:00 – 10:05 Fjala Hyrëse – Drejtore e Sekretariatit të KKZHE-së, z.Lindita Daija
- 10:05 – 10:25 Pakoja Emergjente për bizneset – Ministri i Financave dhe Transferëve, z.Besnik Bislimi
- 10:20 – 10:40 Zhvillimet në Sektorin Financiar dhe ndikim në ekonomi nga Banka Qendrore e Kosovës, Guvernatori i Bankës Qendrore z.Fehmi Mehmeti
- 10:40 - 11:00 Segmentet kryesore të ndikimit ekonomik të pandemisë Covid-19 – Sekretariati i KKZHE-së
- 11:00 – 11:20 Të gjeturat preliminare nga Anketa e Odave të Bizneseve – Drejtor Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës, z.Arian Zeka.
- 11:20 – 12:05 Diskutime tjera nga pjesëmarrësit tjerë të Odave të Bizneseve
- 12:05 – 12:10 Konkludimet dhe përmbyllja e takimit

## TABELA E PJESËMARRËSVE

Besnik Bislimi	Ministria e Financave dhe Transfereve
Fehmi Mehmeti	Banka Qendrore e Kosovës
Edison Jakurti	MEPTINIS
Berat Rukiqi	Oda Ekonomike e Kosovës
Arian Zeka	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
Bersant Disha	Recura
Nora Hasani	Oda Gjermano-Kosovare
Lumnije Ajdini	Aleanca Kosovare e Bizneseve
Emrush Ujkani	Këshilli i Investitorëve Evropian
Astrit Panxha	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
Skender Krasniqi	Oda e Afarizmit të Kosovës
Saxhide Mustafa	Forumi Ekonomik i Grave
Linda Shala	Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7
Arieta Vula Pozhegu	Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës
Blerta Qerimi	Banka Botërore
Leonora Kusari	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Arianit Blakaj	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Dren Pozhegu	Ambasada Amerikane në Kosovë
Dardane Peja	USAID
Lindita Daija	Sekretariati i KKZHE-së
Gent Nushi	Sekretariati i KKZHE-së
Dita Dobranja	Sekretariati i KKZHE-së
Fjolla Metaj Gashi	Sekretariati i KKZHE-së

## SHËNIMET KYQE NGA TAKIMI

**Lindita Daija:** Përshëndetje i nderuar Ministër i Financave dhe Transfereve z. Bislimi, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës z. Mehmeti, dhe ju të nderuar anëtarë përfaqësues të odave dhe asociacioneve të biznesit. Një përshëndetje dhe për partnerët tanë të cilët gjithashtu kanë konfirmuar pjesëmarrjen në këtë takim, ku sot kemi ftuar dhe përfaqësues të BERZH-it.

Siç e dini Sekretariati i KKZHE-së këto ditë ju ka dërguar dhe raportin e gjatë dhe shumë të thukët të analizave makroekonomike, i cili besoj se do të ju shërbej të gjithëve në punën e mëtutjeshme. Për mëtutje kemi lënë hapsirë të gjatë për diskutim dhe besoj se kjo do të na ndihmoj që sapo të fillojnë takimet e Grupit Korodines do ta kemi më të qartë se si do të kyqemi në punën e mëtutjeshme të ekonomisë dhe zhvillimit të intervenimeve të reja. Unë nuk po e zgjas më shumë për t'ju lënë sa më shumë hapsirë të gjitha odave, mirëpo për çfarëdo pyetje që mund të keni unë jam këtu dhe mund të ju përgjigjem. Ju falenderoj edhe një herë të gjithëve dhe kërkoj edhe një herë mirëkuptimin tuaj që kemi dërguar ftesë në më pak se 24 orë, por jemi duke punuar në një tempo shumë dinamike.

Ju faleminderit!

Fjalën ja lë Ministrin të Financave dhe Transfereve z. Besnik Bislimi.

**Besnik Bislimi:** Mirëmengjesi të gjithëve. Shumë faleminderit për interesimin që edhe një herë me më ndigju për disa detaje në lidhje me pakon dhe indikatorët. Me mua është edhe zëvendësministri Ilir Aliu i cili në vazhdimësi është takuar me përfaqësuesit e odave dhe në ato raste ku unë nuk kam pasur mundësi të takohem, Iliri ka qenë ura lidhëse me odat dhe sistemin bankar. Prandaj jam shumë mirënjohës sepse një barrë të madhe e ka marr përsipër. Kam një përshtypje se odat kanë komunikuar më lehtë me Ilirin se sa me mua për arsye se edhe koha e takimeve ka qenë e mjaftueshme sa ka pasur nevojë. Megjithëse unë jam munduar në maksimum me e nda kohën për përfaqësuesit e odave dhe sindikatave, jam i vetëdijshëm se kjo nuk mjafton për aq sa ka nevojë. Prandaj do të kisha dashur të falenderoj secilin prej tyre për durimin që kanë pasur dhe dua ta potencoj se jam munduar që çdo rekomandim që kam pranuar nga ata jam munduar me i marr parasysh dhe me u mundu sa më shume t'i akomodoj ato kërkesa, mbrenda mundësive që i ka buxheti i shtetit. E kemi cekëur disa herë se pakoja është emergjente dhe nuk mundet me i adresu të gjitha nevojëat mirëpo, adreson vetëm problemet më emergjente që i ka komuniteti i biznesit.

- I. Sigurisht se ka vend për kritikë dhe pyetja e parë se a është pakoja më e mirë duhet të dihet se me çka e krahason. Në qoftë se e krahasojmë me një pako ideale sigurisht që nuk është e mirë, ka devijime, sepse pa marr parasyshë sa mundohet me u targetu të gjithë personat apo bizneset e dëmtuara ato nuk mund të përfshihen në tërësi. Ka aq shumë specifika në sektor të caktuar dhe mbrenda tyre për kompani të caktuara sa që është e pamundur Pakoja Emergjente t'i adresoj të gjitha këto. Mirëpo mendoj se kualiteti i pakos duhet të vlerësohet duke u krahasuar me alternativat tjera ekzistuese brenda dhe me pakot të cilat i kanë përgaditur vendet në rajon. Në këtë kontekst mendoj se kjo pako është dukshëm më e kompletuar dhe sidomos është më e mirë në raport me pakot të cilat i kanë përgaditur vendet e rajonit.
- II. Rreth pyetjës se a është pako e mjaftueshme, prap më duhet të them se përgjigja është relative. E mjaftueshme për çka? Në qoftë se është e mjaftueshme me i përballu të gjitha humbjet apo të gjitha dëmet që i ka shkaktuar pandemia bizneseve dhe amviserive, sigurisht se përgjigja është jo. Mirëpo as nuk ka qenë synimi i pakos me i mbulu të gjitha dëmet sepse në qoftëse vetëm një ditë ekonomika nuk prodhon, ajo madhësia që ne e quajmë GDP ka me u zvogëlu. Rrjedhimisht me një GDP më të vogël ne nuk mund t'i kompenzojmë humbjet. Një gjë e tillë është e pamundur. Idea është se si me balancu parën e humbur tek të gjithë participantët në ekonomi.

- III. A është pakoja e drejtë prap përgjigja varet prej këndvështrimit. Gjithmonë kur ka një shumë të parave që do të shpërndahet në bazë të kriterëve të caktuara pra është legjitime që secili subjekt është pjesë e pakos me u përpjekë me e nda një porcion më të madh për kategorinë që e përfaqëson. Prandaj nëse marrim në mënyrë kraciale asnjëri nga participantët nuk ka me u nda i kënaqur. Familjet do të ankohen se po ju ndahet vetëm një përqindje e vogël (16%), sektori privat mund të thotë që për ata vetëm 55%, sektori publik mund të deklarohet si shumë e vogël për 29%. Do të thotë ne si shtet mund të deklarohemi se po na duhet të bartim humbjent doganore përderisa po na duhet të rrisim shpenzimet, kështu që është e qartë se në fund pakoja nuk mund të i përmbush interesat që i kemi në tërësi.
- IV. E fundit që kisha me shtu është se a është pakoja e implementueshme. Ajo është e zbatueshme. Janë përhapur dezinformata se pa intervenimin e parlamentit nuk mundet, pakoja është e komplikuar etj. Ndërsa unë mund të ju them vetëm një gjë, sikur të kishim mbështetjen e parlamentit dhe sikur të ishim të gjithë unik në adresimeve e nevojëve të COVID-19, pakoja kish me u implementu shumë më lehtë dhe me dëm shumë më të vogël të buxhetit. Mirëpo pakoja implementohet edhe nëse parlamenti vendos që komplet të bllokoi qeverinë. Zëvendësministri është duke u munduar që tash e disa ditë me ndihmën e ekspertëve mbrenda ministrisë për të parë opsionin se si zabtohet secila pjesë e pakos mbrenda buxhetit të shtetit edhe përkundër mos gatishmërisë së parlamentit për me i dal në ndihmë qeverisë dhe biznesit. Kjo ishte për çështjet e përgjithshme që kanë të bëjnë më pakon, nderisa për specifikat ne i kemi përmend disa herë. Qëllimi i pakos është:
1. Me i mbrojt qytetarët
  2. Me i mbrojt punëtorët
  3. Me i mbrojt bizneset
  4. Me i mbrojt komunat

Këto janë katër kategori të cilat e bartin një barrë të madhe si rezultat i situatës që e kemi në treg. E dijm se kriza është krizë shendetësore mirëpo manifestimi i saj është shumë më i madh në rrafshin ekonomik se sa në rrafshin shendetësor. Rrafshi shendetësor atakon një pjesë shumë të vogël të qytetarëve ndërsa ai ekonomik e prek pothuajse secilën familje dhe secilin biznes. Prandaj ka qenë shumë e rëndësishme që t'i adresojmë ato. Një pjesë e qytetarëve është rreziku shumë për shkak të rritjes së çmimeve në treg dhe për shkak të hapsirave të vogla që tash kanë për të manovru. Ne këto i kemi adresu përmes një sër pikash të pakos p.sh pika 1.1 që i adreson skemat sociale, ndërsa pika 1.2 skemat e pensionale, ku niveli i pensionit nuk është i mjaftueshëm as për me i ikë varfërisë ekstreme, skema 1.8 për ata që mbesin të papunësuar, pika 1.9 që adreson komunitetet rom, ashkalinjë dhe egjiptian dhe pika 15 që nëse e analizojmë mirë është një skemë sociale alternative për ata të cilët në këtë periudhë i nënshtrohen rrezikut të varfërisë.

Punëtorët janë adresuar përmes disa pikave si 1.3; 1.6; 1.7; 1.8 dhe 1.14. Që u jep mundësinë punëtorëve të cilët kanë qenë të detyruar të rrin në shtëpi si rezultat i masave ose nuk kanë mundur të punojnë me kapacitet të plotë. Megjithatë, të i marrin të ardhurat e tyre. Atyre të cilët janë lajmëruar tani me marr të ardhura, përkundër faktit që deri më tani kanë qenë në ekonominë joformale. Është shumë me rëndësi me e potencu për komunitetin e biznesit që të ja bëjnë të qartë gjithë anëtarëve të tyre që kjo është një mundësi e mirë dhe jo instrument për të cilën Administrata Tatimore e Kosovës e synon ta përdor për ndëshkime të më vonshme. Për një gjë të tillë mund të ju siguroj që në asnjë moment nuk ka qenë as idea më e vogël që me përdorë këtë masë kundër biznesit. Mirëpo është një mundësi e mirë për formalizmin e ekonomisë me që në këtë mënyrë i ndihmojmë edhe atyre që punojnë me kushtet e konkurrencës së ndershme dhe në të njëjtën kohë me ju tregu bizneseve që formalizmi e ka një benefit, për arsye se anjherë nuk i dihet ekonomisë mundet me pas nevojë për mbështetjen e shtetit.

Sa i përket komunave, ne e dijm se ato janë ballafaquar me shpenzime shtesë. Një pjesë të këtyre shpenzimeve që janë direkt shendetësore i komenzojmë përmes 10.15 milion Euro që i kemi nda për

masat COVID-19, plust 5 milion Euro nga Bashkimi Evropian, plus ndihmesat që kanë ardhur si ndihmë nga Norvegjia, Turqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pjesa tjetër e pakos është komplet e orientuar nga bizneset me që ne e kuptojmë rolin qëndorë që ka biznesi. Ne kemi analizuar cilat janë kanalet përmes të cilave biznesi dëmtohet dhe si p.sh nëse për shkak të vendimeve tona kufizohet ushtrimi i aktivitetit, bizneset përballen me ramje të hyrave por në të njëjtën kohë ato kanë më qenë të detyruara të i kryejn disa detyrime si ato ndaj sistemit bankar. Ne kemi intervenu me vullnet të mirë së bashku me zëvendësministrin, ndërsa Banka Qëndrore me vendime, sepse ajo është kompetencë ekskluzive e BQK-së. Pra bizneset që kanë telashe në këtë drejtim të ju shtyhet shlyerja e këtyre obligimeve. Kemi thënë se kanë obligime ndaj punëtorëve kemi marr përsipër pagën e epërme minimale. Kemi thënë se kanë obligime ndaj qiradhënësve, prandaj kemi marr masën për mbulimin e gjysmës së qiradhënies. Kemi thënë se kanë probleme me likuiditet dhe kemi intervenu me masat që janë 1.5 dhe 1.10. Kemi thënë se mund të kenë probleme me mundësinë për shtyerjen e obligimeve tatimore dhe u kemi ofru këtë hapsirë. Poashtu kemi intervenuar edhe në uljen e kostos së lëndës së parë gjatë kësaj periudhe. Tek punëtorët, zëvendësministri po më korrigjon, jo vetëm që kemi marr përsipër një pjesë të pagës por edhe kemi marr përsipër pjesën e pages dhe mbulimin e kontributeve të skemes pensionale dhe atyre tatimore. Për ato kompani të cilat nuk kanë pasur mundësi tjetër përveq largimit nga puna të disa punëtorëve është masa 1.8 ku ne ju kemi sugjeru kompanive se është mirë të mbajnë kontigjentin e fuqisë punëtore, me që në atë mënyrë ne i kompenzojme me shumë prej 170 Euro, ndërsa duke i larguar nga puna i përfitojnë vetëm 130 Euro. Mirëpo ka rrezik që nëse i largojnë nga puna këta punëtor ata të levizin tek ndonjë konkurrent apo biznes tjetër dhe kanë të vështirë që pas kalimit të pandemisë të i kthejnë në punë. Mirëpo edhe si përgjegjësi sociale e kompanive mesazhi është shumë më i fuqishëm nëse kompania deklaron dhe i mban punëtorët e tyre. Pra edhe nëse punëtori rri në shtëpi është mirë të i mbajnë në listë të pagave me që ndihma nga shteti vjen prej 170 Euro.

Dua te i ndaj 3 informata me ju, mesazhe ku kompanitë e caktuar, disa mjaft të mëdha menjëherë pas inicimit të masave kanë larguar punëtor nga puna. Dua të theksoj se këto kompani nuk kanë me qenë të privileguara gjatë periudhës së rimëkëmbjes ekonomike ku kushtet e huamarrjes kanë me qenë shumë më të mira për ato kompani që vendosin me e rujt fuqinë punëtore në këtë krizë.

Mesazhi tjetër është nga noterët e Kosovës ku biznese të caktuar po vizitojnë zyrat e tyre me kërkesën për ndryshimin e kontratave për qira, me shuma të dyfishuara me idenë që në këtë mënyrë të marrin komenzime më të mëdha. Një gjë e tillë nuk preferohet me që ne do t'i marrim për bazë vlerën e paguar gjatë muajit shkurt.

Mesazhi i tretë është se kemi informata se banka të caktuara po i motivojnë huamarrësit të nënshkruajn planet e reja të pagesave me kamata shtesë, me dezinformatën se nënshkruani se qeveria do t'a marr përsipër mbulesën e tyre. Do të ishte mirë ndalimi i tyre për shkak që ato krijojnë pritshmëri tek qytetarët. Në këtë situatë është shumë me rëndësi të mos krijohen pritje të pa realizueshme nga të cilat mund të pësojmë të gjithë.

Për fund do të kisha shtuar se, është thënë se nevojitet një qasje shumë e gjërë dhe unë jam munduar të i përfshij të gjithë në këtë fazë. Përfaqësuesit e bizneseve i falenderoj për çdo rekomandim që më kanë dhënë. Një ndër ta edhe z. Skender Krasniqi i cili më dërgon një mori e-maila mbrenda ditës dhe unë i lexoj të gjitha. Gjithashtu edhe Nora Hasani më dërgon e-maila dhe i falenderohem. Me Guvernatorin dëgjohe mi shpesh përmes telefonit të cilit i falenderohem poashtu. Unë po mendoj që sot me e dërgu një ftesë publike tek z. Haki Shatri, z. Avdullah Hoti, z. Agim Krasniqi, z. Bedri Hamza, që kanë qenë të gjithë ish ministra viteve të fundit që të ulemi bashkë dhe të na ndihmojnë me këshillat e tyre në përpilimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Bashkë aty të përfshihen edhe BQK, komuniteti i biznesit dhe sindikatat e punëtorëve.

Unë me kaq po e përfundoj dhe faleminderit shumë për durimin.



**Lindita Daija:** Faleminderit Ministër për këtë prezantim shumë të qart. Vazhdojmë tutje duket ftuar z. Fehmi Mehmeti, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës të marr fjalën.

**Fehmi Mehmeti:** Përshëndetje, ashtu si e potencoi edhe Ministri, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe unë kam shprehur gatishmërinë time të plotë si Guvernator dhe si BQK që të jemi në dispozicionin e qeverisë, ku e kemi edhe obligim ligjor sepse jemi edhe këshilltar i qeverisë, për çkado që kërkohet nga ana jonë si BQK jemi në shërbim të vazhdueshëm me qëllim që sa më lehtë ta tejkalojmë këtë sfidë. E përgëzoj Ministrin Bislimi që i bënë thirrje të gjithë akterëve duke e prioritetuar sfidën e vetmë që e kemi të gjithë së bashku, pra tejkalimin e pandemisë. Pra është shumë ide e mirë që mos të shohim parti politike, por si ekspert të gjithë të takohemi të bisedojmë dhe të japim ide se si ta kalojmë sa më lehtë këtë sfidë si në aspektin shëndetësor ashtu edhe ekonomik.

Jam i nderuar që të marr pjesë në këtë takim me ftesën e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe të prezantoj zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe ndikimet e tyre në ekonominë e vendit. Kriza nëpër të cilën po kalojmë ka filluar të marr përmasat e një krize ekonomike dhe ka filluar të ndikoj negativisht si në të gjitha vendet e botës ashtu edhe në Kosovë. Duke pasur parasysh kërcënimin nga kjo pandemi Banka Qendrore e Kosovës në fazat e para ka marr të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet negative të kësaj pandemie. BQK duke zbatuar plotësisht rekomandimet e institucioneve shëndetësore menjëherë ka arritur që ta rikthej çdo funksion të saj 100% në atë funksional.

Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar, BQK ka qenë pjesë e komunitetit ndërkombëtar dhe instrucional, mes BQK-së, thesarit të shtetit dhe shoqatës së bankave me qëllim të arritjes së funksionimit normal të sistemit financiar në vend. Kemi adresuar disa çështje që kanë kërcënuar funksionimin e rregullt të sektorit bankar. Po i përmendi sektorin bankar, për arsyen se është komponenti kryesor i sektorit financiar. Ky grup ka trajtuar problemet që janë shfaqur në këtë kohë. Duke pasur parasysh ndikimin negativ në aktivitetin ekonomik të vendit, Banka Qendrore së bashku me Shoqatën e Bankave, kanë vendosur që të aplikohet një moratorium për pagesat e kredive për një periudhë 3 mujore, pra deri me 30 prill e më pastaj shihet edhe mundësia që të vazhdohet edhe për 3 muaj. Qëllimi është që të shtyhen këstet e kredive, të mos ketë pagesa ndeshkuese dhe kryesisht mos të ju priset rating-u në regjistrin e kredive. Ky proces deri më tani ka shkuar mirë. Kemi ankesa që nga qytetaret dhe bizneset, ku divizioni mbrenda BQK-së i adreson këto raste. Në lidhje me atë që e përmendi dhe Ministri Bislimi, jam në kontakt të vazhdueshëm me Shoqatën e Bankave dhe bankat komerciale të cilëve ju kam bërë me dije që të kenë kujdesë të shtuar në aplikimin e këtij vendimi të marr, pasiçë sapo të kaloj kjo gjendje ne do të fillojmë ekzaminimin tek secila bankë në mënyrë individuale. Nëse vërehet se ndonjëra nga këto banka nuk është duke i zbatuar rregullat, ju siguroj se ne do të marrim masa të ashpra konform legjislacionit në fuqi. Besoj se bankat e kanë pranuar mesazhin shumë qartë dhe gjatë gjithë kësaj kohe ne veçse i kemi bind të gjitha institucionet financiare se kur është në pyetje zbatueshmëria e vendimeve dhe legjislacionit, BQK tolerancën e ka zero dhe besoj që si rezultata i kësaj nuk ka me pas nevojë as të merren masat ndeshkuese meqë bankat e kanë tashme shumë të qartë.

BQK gjatë gjithë kësaj kohe ka furnizuar dhe vazhdon të furnizoj me para të gatshme të gjitha bankat, me qëllim që të kemi likuiditet të duhur. Gjithashtu kemi filluar me dezinfektimin e rregullt të të gjitha parave me të cilat e furnizojmë tregun, si masë mbrojtëse e shfrytëzuesëve të parave të gatshme. Gjithashtu i është bërë apel të gjithë qytetarëve mbi higjienën sipas instruksioneve të shëndetësisë pas çdo tërheqje bankare apo përdorimi të parave të letrës. Poashtu ne i kemi siguru për sistem të rregullt të sistemit të pagesave në të gjitha vendet përfshirë këtu edhe zonat të cilat kanë qenë të izoluar.

Me qëllim të mbikqyrjes më të përafërt dhe të vazhdueshëm të sistemit financiar BQK-ja ka kërkuar raportim të rregullt ditor nga bankat dhe ne raportojmë me rregull tek Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Niveli i depozitave deri më tani në Kosovë është shumë stabil. Aktualisht raporti i likuiditetit shënon 35.1% që është dukshëm mbi nivelin minimal që kërkohet prej 25%. Ne kemi bërë prerëje me 16 mars ku është paraqitur dhe rasti i parë, ku raporti ka qenë 35%, dhe sot vazhdon me 35.1% ku pra raporti i likuiditetit larg nga minimumi i kërkuar rregullativ.

Ne jemi duke monitoruar depozitat në baza ditore dhe deri më tani nuk kemi tërheqje të lartë të tyre, pra jo për tu shqetësuar, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të likuiditetit të bankave. Jetë likuide të bankave arrijnë në 1.16 miliardë Euro. Ajo çka është e mira që sot më bëri përshtyje, ishte që duke hyrë në bankë e pash që vetëm vijshin pare në bankë për deponim që është diçka shumë pozitive, pra jo tërheqje por deponime.

Jemi gjithashtu në kontakt me bankat qendrore të regjionit dhe së bashku nën ombrellën e Vienna Initiative dhe mbështetjes së EBRD-së jemi duke shqyrtuar mundësinë që t'i propozojmë Bankës Qëndrore Evropiane mundësinë e krijimit të një mbështetje të likuiditetit me qëllim specifik që do t'ju mundësonte bankave qendrore mbrenda vendeve të regjionet, që ballafaqohen me pasojëat e COVID-19. Kjo është një ide që është hedhur nga bankat e regjionit dhe është e mirëseardhur edhe nga ana jonë, edhe pse sistemi jonë bankar mbetet shumë likuid dhe nuk besoj se do të kemi nevojë që të përdorim një fond të tillë, ku idea për të ka ardhur specifikisht nga Maqedonia. Për të cilën e dijm se qysh në fillimin e kësaj krize ky shtet ka pasur nevojë për likuiditet.

Spektori bankar është shumë mirë i kapitalizuar. Aktualisht raporti i mjaftuesmërisë së kapitalit është 16%, që është larg mbi minimumin rregullativ që kërkohet të jetë 12%. Në të shprehur në terma absolut kapitali i bankave është për 140 milion Euro më i madh se sa minimumi i kërkuar rregullativ. Banka Qendrore për të mbajtur këtu nivelet e kapitalit, me shumë kujdesë do t'i shqyrtojmë edhe kur kemi të bëjmë me pagesat për dividendat e viteve të kaluara. Nuk po e them në mënyrë të prerë se nuk do të ketë aprovim të dividendës, por do t'i shqyrtojmë shumë me kujdes.

Spektori bankar i Kosovës gjatë gjithë kohës ka qenë stabil dhe vlersimin që e bëjmë ne dhe mbrikqyrja nga institucione internacionale si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, kredita përformuese, po flas për muajin mars ka qenë 2%, nivel ky që është dukshëm më i lartë se në të gjithë rajonin. Njëkohësisht është më i ulët se sa në disa vende më të zhvilluara të Bashkimit Evropian. Ne besojmë se duke pasur parasysh edhe zhvillimin financiar aktual të bankave se sektori bankar me sukses do të jetë në gjendje ta përballoj këtë sfidë. Meqenëse ne mbikqyrim dhe Fondin e Kursimeve Pensionale, i cili është ekspozuar nga zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare megjithatë përkundër humbjeve të larta të zhvilluara në 3 muajin e parë, ngritja e çmimeve në tregjet e letrave me vlerë kanë zvogëluar humbjet në 53 milion Euro aktualisht. Do të thotë Fondi Pensional i Kosovës aktualisht ka të investuara në BQK në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe depozita në Bankat e Kosovës një shumë prej 545.5 milion Euro. Ne kemi kërkuar dhe kemi raportim të rregullt prej Fondit të Kursimeve Pensionale në BQK për të përcjellur gjendjen se në çfarë kahje është duke shkuar.

Sa i përket sektorit të sigurimeve si pasojë e kufizimit të qarkullimit sektori i sigurimit ka shënuar një rënie për afro 50%. BQK u ka mundësuar kompanive të sigurimit që të shesin policat e sigurimit online e cila shpresojmë që do t'ju mundësoj qytetarëve dhe kompanive të sigurimit që në mënyrë më efikase të sigurojnë automjetet në vend. Gjithashtu kemi qenë në mbështetje të vazhdueshme në nivel të regjionit, Bashkimit Evropian, atij ndërkombëtar si dhe kemi qenë në kontakt të rregullt me të gjithë bashkëpunëtorët tonë ndërkombëtar përfshirë FMN, Bankën Botërore, EBRD-në. Gjithashtu Ministri Bislimi e din se kemi asistuar në rritjen, apo financimin prej 52 milion Euro financim që ka ardhur, dhe jami lumtur që ajo është aprovuar nga Bordi Ekzekutive dhe nuk ka kufizime dhe mund të përdoret për Pakon Emergjente të cilën e përmendi Ministri.

Një kanal tjetër shumë i rëndësishëm i ekonomisë së vendit që është goditur nga kriza pandemike, është edhe sektori i jashtëm. Ku Kosova ka një vartësi mjaft të lartë nga remitencat, duke pasur parasysh faktin që diku rreth 10% e GDP-së në baza ditore vjen nga remitencat. Rënia ekonomike në vendet e botës pa dyshim që pritet të zvogëloj edhe këtë burim shumë të rëndësishëm të financimit dhe

konsumit në vendin tonë. Përkundër rrjedhjes së qëndrueshme që e kanë pasur remitencat e Kosovës, nëse e marrim si reference vitin 2009 kemi pasur rënie të remitencave diku 5.5% e që ka ndikuar në tri vitet në vijim 2009, 2010, 2011. Mund të them se kjo krizë aktuale nuk mund të krahasohet me asnjë krizë ekonomike më heret. Sidomos rënia e remitencave në Kosovë do të ndikoj duke e ditur rënien ekonomike në dy shtete prej nga remitencat më të mësha vijn nga Gjermania dhe Zvicra.

Si pasojë e rënies së kërkesës së përgjithshme pritet që me rënie të karakterizohen edhe eksportet tona. Njësoj rënie do të kemi dhe në investimet e huaja direkte. Ne konsiderojmë se masat e marra nga institucionet e vendit do të arrijn të zbusin efektin e krizës, por nuk janë të mjaftueshme për të menjanuar ato plotësisht. Pavarësisht se efektet e krizës sot janë vështirë të parashikueshme sepse ende ka pasiguri kundrejtë pandemise si kohëzgjatje e përmasat. Aktualisht të gjitha shtetet kanë ndryshuar parashikimet makroekonomike për vitin aktuar dhe vitet më pas.

Ashtu si e sqaroj dhe ministri në takimet që i kemi pasur, unë besoj që kjo është një pako emergjente dhe i adreson vetëm çështjet emergjente, ndërkaq pakot vijuese për rimëkëmbje ekonomike, e cila është një pako krejt tjetër dhe ka të bëjë më rimëkëmbjen ekonomike ku kemi pranuar edhe ftesë zyrtare nga Ministri Bislimi që të marrim pjesë në draftimin e kësaj pako. Shpresoj se aty do të përfshihet një program për subvencionim të kredisë për sektor të caktuar, për një apo dy vite. Po flas për këto vetëm si propozime tona që pastaj do t'i diskutojmë bashkërisht edhe me Ministrin dhe kabinetin e tij.

Me supozime se pasojat ekonomike do të ndjehen në ekonominë e Kosovës më tepër në 3 mujorin e parë, dytë dhe të tretë dhe në tremujorin e katërt parashikimet tona janë se do të filloj të rimëkëmbet ekonomia, mirëpo ne sugjerojmë që të kemi një rënie ekonomike deri ne -4% deri ne vitin 2020. Si do që të jetë këto parashikime do të thojnë të mirren me rezervë sepse ne po sillemi me shumë vëmendje të lartë dhe zhvillimet ekonomike si ne Kosovë ashtu edhe në nivel global, duhet të rishikohen edhe me parashikimet tona makroekonomike. FMN ka dhënë një argumentim që do të ketë një rënie ekonomike në Kosovë prej -5%, ndërsa Banka Botërore -6%, mirëpo parashikimet tona janë që me lëviz prej -2% deri në -4%. Ruajtja e shëndetit të ekonomisë me sa më pak pasojë për ta ruajtur edhe mirëqenien e qytetarëve gjatë dhe pas krizës, prandaj edhe kjo është një detyrë përgjegjëse shumë e rëndësishme dhe që na takon të gjithë neve, drejtuesëve të institucioneve e sidomos neve që kemi ndikim të drejtëpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Kemi shqyrtuar dhe një seri opsionesh që do t'i ndërmarrim në vijim po qe e nevojshme. Ta rrisim kreditimin, ta rrisim përkrahjen ekonomike, të zvogëlojmë kërkesat e likuiditetit, pezullim të paraqitjes së dividendës për institucionet financiare. Fokusi duhet të jetë tek Fondi i Garantimit të Kredive, ku rritja e këtij fondi do të lehtësoj qasjen në financa dhe normën e interesit. Megjithatë, në përkrahje nga ky Fond mund të jenë bizneset të cilat të demtuara financiarisht nga situata e krijuar. Do të thotë që në këtë situatë prioritë do të kenë bizneset të cilat janë afektuar ekonomikisht nga pandemia COVID-19. Propozimet tona janë që, si e ka përmendur Ministri edhe disa herë të tjera, pritet ratifikimi i një marrëveshje në kuvend për rritjen e këtij fondi edhe prej 25 milion dollar. Në video-konferencën që e kemi pasur me Bankën Botërore, kanë shprehur vullnet që të na përkrahin sërish me fonde shtesë, KFË, USAID poashtu dhe institucionet ndërkombëtare të tjera relevante që ky fond të rritet dhe njëkohësisht të rritet edhe përqindja e garantimit të këtij fondi. Ne jemi duke punuar dhe me një kohë të përshtatshme do ta shpalojmë edhe me Ministrinë e Financave se si duhet ta dizajnojmë dhe nga do të shkoj ky fond në të ardhmën. E para është që ky fond duhet ka kaloj apo ta rrit përqindjen e garantimit që ne propozojmë të jetë deri në masën 70%, që atëhere banka do të marr shumë më pak rrisht dhe do të ndikoj në uljen e normës së interesit. Pos kësaj do të shikojmë mundësinë që përmes këtij fondi të bëhet edhe subvencionimi i normës së interesit, por uroj të mos kemi nevojë sepse ligji aktual nuk e përjashton mundësinë që kjo e ka edhe një dritare edhe kreditu nga ky fond.

Kaq sa për fillim nga unë. Uroj që të keni shëndet ju dhe familjet e juaja dhe të kalojmë sa më lehtë këtë pandemi. Jam ne dispozicionin tuaj për çdo pyetje që mund të ma drejtoni.

Ju faleminderit shumë!

**Lindita Daija:** Faleminderit shumë z. Mehmeti. Ishit shumë i detajuar, por më së shumti faleminderit për qasjen gjithpërfshirëse dhe bashkëpunimit pavarësisht rrethanave të tjera.

Për të bërë një urëlidhje në mes të Qeverisë së Kosovës dhe sektorit privat, kuptohet se Sekretariati i KKZHE-së ka bërë një raport të thukët, pasiçë në takimin e kaluar të nivelit të KKZHE-së nuk pati kohë të ndalemi tek ato dy raporte, sot kolegja ime Dita Dobranja, Ekspërte Ekonomike do të fokusohet në ndikimin ekonomik dhe segmentet kryesore që ka pandemi a COVID-19. Pastaj do të vazhdojmë tutje në diskutime me odat. Për më shumë pas takimit do të ju dërgojmë matricën të kthyer me përgjigje nga të gjithë ministrat respektiv nga takimi i parë. Këtë raport të gjatë të Sekretariatit të KKZHE-së që mund të ju ndihmoj juve si dhe raportin e parë, pasiçë kemi pranuar rekomandime shtesë dhe do të jetë i plotësuar me këto të dyja. Ju faleminderit!

**Dita Dobranja:** Faleminderit Lindite. Me lejoni që dhe unë të falenderoj Ministrin Bislimi dhe Guvernatorin Mehmeti për një prezantim të detajuar, me informata shumë më shumë se ato që i kemi pasur. Në mënyrë që të mbetet sa më shumë hapsirë për diskutim, unë prezantoj në pika të shkurta raportin të cilin ne e kemi publikuar. Ashtu si e përmendën edhe Ministri dhe Guvernatori në këtë kohë të cilën jemi momentalisht ka shumë të panjohura dhe ka ndryshime nga dita në ditë si nga ana e shëndetësisë ashtu edhe e ekonomisë. Për të parë ndikimin e pandemisë në zhvillimin ekonomik dhe për të parë se cilët sektor do të ndikohen më shumë si për nga niveli i kontributit që ata kanë në ekonomi, poashtu edhe nga niveli i ndikimit në punësim.

Ne kemi realizuar një dokument i cili është i detajuar dhe ka shumë shtojca, ku mundeni me e pa edhe mënyrën e qasjes që e kemi marr. Qëllimi i këtij dokumenti ka qenë me e pa se cilët sektor, bazuar në të dhënat e vitit të fundit, ka ndikim më të madh në GDP-në e vendit, pra në Bruto Produktin Vendor dhe në punësim. Për të parë nivele të ndryshme të ndikimit të pandemisë ne i kemi bërë disa skenar të ndryshëm meqë në këto kohë e vetmja mënyrë për të ardhur me analiza është të testojmë skenar të ndryshëm, si për nga niveli i veprimtarisë së sektorëve sa mund këto sektore të punojnë gjatë kohës së izolimit dhe limitimeve nga qeveria apo nga limitet e vet atyre për arsye të ndryshme. Këto raste i kemi krahasuar apo kundërkrahasuar me skenar të ndryshëm të kohëzgjatjes së pandemisë dhe izolimit, në mënyrë që të dalim me një analizë e cila na jep një pamje më të qartë se si mund të ndikojnë masat e ndryshme. Është e kuptueshme megjithatë po e cekë se sa me e gjatë koha e limitimeve dhe ndikimi do të jetë më i madh, por që vazhdimi i disa sektorëve edhe gjatë kësaj periudhe mund të ndikoj që rënia të mos pësoj ndryshim drastik.

Sipas kësaj analize që kemi realizuar skenari më i mundshëm na jep edhe ne aty diku afër një rënie të GDP-së siç e tha edhe Guvernatori Mehmeti mes -2% deri -4%, dhe ne skenarët më të rënda deri në -5% mirëpo po shpresojmë që nuk do të kemi rastin me i përjetu këto skenare.

Sa i përket anës së punësimit skenare të ndryshme tregojnë që do të ketë humbje të punës afatshkurtër dhe afatgjatë. Ka sektor të cilët do të kenë persona ku do të humbin vendin e punës gjatë kohës së izolimit strikt, mirëpo këto vende të punës kanë dhe gjasa të mëdha që të kthehen pas përfundimit të masave të izolimit. Atë që e përmendi Ministri Bislimi dhe që është shumë me rëndësi e që na jep informata shtesë për analizën tonë është që të inkurajohen bizneset që të mos i përfundojnë kontratat po të i mbajnë në lista të pagave punëtorët e tyre duke qenë që kjo do të ju ulë koston e rikthimit në veprimtaritë e tyre. Një gjë të cilën e kemi rekomanduar jo vetëm në raportin e dytë por edhe në atë të parin, duke e bërë të ditur se bizneset duhet të kenë parasysh pastaj koston shtesë për të pranuar persona të ri në punë.

Tash të fokusohemi shumë shkurt edhe në sektor, për nga niveli që kanë në GDP, sektori që ka më se shumti ndikim është tregëtia me shumicë dhe pakicë që për momentin është sektori i cili është tu punu pjesërisht domethënë me ushqim dhe pije. Sektori i dytë është sektori i prodhimit, pastaj vjen sektori i

ndërtimtarisë. Këto tri sektore përveq kontributit në GDP janë edhe sektoret që përbëjnë numrin më të madh të punësuarëve në vend. Një gjë që është mirë ta kemi parasysh është sektori i hotelierisë dhe restoranteve, e cila si sektor edhe kontributin në GDP-në e Kosovës e ka vetëm 2% ky sektor punëson rreth 6% të të punësuarëve, apo sipas shifrave të vitit 2019 afër 27,000 persona janë të punësuar në këtë sektor. Duke ja shtuar këtu edhe një dozë të skepticizmit për faktin që ky sektor ka një nivel më të lartë të informalitetit duhet pasur parasysh që numri i personave që mund të humbin punën në këtë sektor mund të shkojë edhe më lartë se shifrat e përmendura.

Për përfundim përveq faktit që pandemia do të ketë ndikim në ekonominë globale dhe jo vetëm në Kosovë, besojmë se ka shumë rëndësi fakti që kemi një vartësi shumë të madhe në remitenca, siç e përmendi edhe Guvernatori Mehmeti, e mira në këtë fatkeqësi është që Kosova nuk është shumë e integruar si ekonomi, pra nuk kemi nivel të lartë të eksporteve mundemi me reflektu që ndoshta edhe kur fillon me u rrit kostoja e importeve pas pandemisë ka me pas edhe rritje të prodhimit vendor. Me shpresë që një pjesë e atyre që kanë qenë importe të zevendoësohen me produktet vendore. Ndoshta kjo mund të jetë edhe një ndikim pozitiv si rezultat i kësaj. Gjithashtu, duhet pasur parasysh që Kosova nuk ka varshmëri në turizëm siç ka p.sh Mali i Zi dhe Shqipëria, mund të jetë edhe një e keqe pak më e vogël sa i përket një të keqe që mund të ketë pandemia në vendin tonë.

Me kaq unë po e mbyll për të mos marr më shumë kohë që të vazhdojmë tutje me sektorin privat. Faleminderit!

**Lindita Daija:** Faleminderit shumë Ditë! Një prezantim i shpejtë mirëpo me pikat kyçe dhe besoj që nga tri prezentimet deri tani sektori privat e ka rradhën që të diskutoj dhe prezantoj shume pika të tjera.

Sipas agjendës parase të fillojmë me diskutimin e kemi dhe Arian Zeka nga Oda Ekonomike Amerikane, i cili do t'i cekë disa pika kyçe për zbatimin e Pakos Fiskale Emergjente si dhe do të ofroj disa sugjerime për Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe pastaj vazhdojmë me diskutime.

**Arian Zeka:** Faleminderit Lindite. Përshendetje për të gjithë, për Ministrin e Financave, Zëvendësministrin që po ndan kohën që të jetë serisht me ne. Kjo është taman një konfirmim i partneritetit që duhet të ekzistoj në mesë sektorit publik dhe atij privat. Pa humbur më tej kohë në agjendë realisht ka qenë e planifikuar që të prezantohen të gjeturat preliminare të një ankete të cilën e kemi kryer bashkërisht një grup i asociacioneve të bizneseve dhe ekspërtëve të ndyrshëm i cili është kryer menjëher pas shpërthimit të pandemisë. Kontribuesit janë: Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Këshilli i Investitorëve Evropian dhe Klubi i Prodhuesëve të Kosovës, të renditura sipas kohës së krijimit pra nivelit të senioritetit, jo domosdoshërisht sipas kontributit që kanë dhënë në mbrenda grupit. Poashtu pjesë e grupit ka qenë edhe Bersant Disha-Expërt Financiar, Ardi Shita – Expërt Ligjor, Eriola Biboli, Ilir Aliu, Visar Ramajli dhe Visar Kelmendi. Kemi vendosur që të gjeturat e anketës t'i prezantoj Bersant Disha meqenëse ka dhënë kontributin më të madh në draftimin e pyetësorit, i cili fillimisht është përgaditur nga Klubi i Prodhuesëve të Kosovës. Në të njëjtën kohë Bersanti është duke u marr ende me analizimin e detajuar të të gjeturave për të cilat ne besojmë që do të kenë një rolë të rëndësishëm përgjatë ditëve në vijim dhe në procesin e vendimmarrjes së mëtejme.

Ministri e tha që realisht ka disa prej nesh që nuk jemi të kënaqur me anketën, mirëpo ne e marrim imputin direkt nga bizneset dhe besojmë se shumica është shumë më e madhe se çka është paraparë në Pakon Emergjente, por në të njëjtën kohë e kemi thënë disa herë ne jemi të vetëdijshëm për kapacitetet buxhetore në vendin tonë dhe për aftësinë e shteti për të reaguuar në situata të tilla. Ajo çfarë do të kërkoja nga shumë shpejtë nga Ministri i Financave dhe Zëvendësministri, më të cilin poashtu kemi qenë në kontakt gjatë ditëve të kaluara është aplikimi i procedurave të përsheptuara për aplikacionet që janë plotësuar tashmë apo janë pranuar dhe fillimi më i shpejtë i disbursimit të mjeteve financiare për ndërmarrësit dhe punonjësit. Tashmë është diskutuar që ekziston një defekt brenda formularit

elektronik për parashtimin e aplikimit për kompenzim të pagave nga kompanitë që i kanë ekzekutuar tashmë pagat për muajin mars edhe e di që edhe Zëvendësministri Aliu është i vetëdijshëm për këtë çështje, e edhe Administrata Tatimore dhe është diçka në të cilën po punohet që të zgjidhet. E kam dërguar menjherë atë ditë pas përfundimit të takimit të KKZHE-së edhe kërkesën që Grupi Koordinues i cili është krijuar në takimin e fundit të nis punën sa më shpejtë. Normalisht jo gjithçka mund të kryhet tash në këtë periudhë, meqë një pjesë e madhe e elementeve të cilat do t'i përfshijmë në programin e madh të rikuperimit do të kërkojnë edhe një vlerësim më të detajuar nga të gjithë për ndikimin që COVID-19 do të ketë edhe në sektorin privat edhe në ekonomi. Megjithatë, disa çështje mund të fillojnë të diskutohen edhe disa propozime dhe rekomandime mund të i japin qysh tash.

Meqenëse e kemi edhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës do ta shfrytëzoj mundësinë edhe një herë, e tha edhe Ministri i Financave Bislimi, besoj që do ta thonë edhe kolegët e mi të tjerë që të bëhet një sqarim më i detajuar i vendimit që BQK ka nxjerr bashkë me bankat komerciale dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës meqenëse një numër i madh i ankesave nga ana e bizneseve ditëve të fundit ka qenë pikërisht sa i përket detyrimeve të tyre kreditore dhe mundësisë të shtyrjes së tyre gjatë kësaj kohe.

Kërkesa e fundit për Ministrin e Financave, e di që është diçka procedurale dhe mesiguri do të bëhet, të shtyhet sërisht data e raportimit tatimor, për momentin është deri me 30 prill edhe e pagesës nëtënjejtën kohë. Pra të bëhet edhe shtyrja e pagesës në të njejtën kohë dhe e deklarimit dhe le të shtyhet deri le të themi me 30 qershor, meqenëse po shihet që pandemia do të zgjas edhe përgjatë muajit prill.

Fjalën po ja kaloj Bersantit i cili do t'i prezantoj të gjeturat e anketës dhe faleminderit për vëmendjen.

**Bersant Disha:** Mirëdita të gjithëve unë do të tentoj me qenë sa më i thukët në këtë prezentimin e gjetjeve. Do ta bëjë "Share Screen" të raportit i cili është punu pak më shpejtë e shpejtë. Mirëpo do të tentojmë me e bo zbërthimin edhe me sektorët specifike dhe të ju dërgojmë një raport pak më të zgjeruar diku ka fillimi i javës së ardhshme. Ku të gjetuaret vijnë nga te dhënat e marra nga bizneset anëtare të odave që i përmendi Ariani dhe në bazë të saj me e vlersu ndikimin që ka kjo krizë. Studimi është bërë para dy jave faktikisht, ku ka diku 1 javë që është mbyll anketa kështu që kjo reflekton vetëm ato përshtypjet e para që kanë bizneset për ndikimin e krizës. Do të ishte mirë që odat të vazhdojnë ta bëjnë këtë periodikisht, së paku 1 herë në muaj për të parë edhe si po evoluon në vazhdimësi ndikimi. Pa marr shumë kohë po tetoj me e bo një "Share Screen" të prezentimit.

Po kaloj te gjetjet kryesore për të mos marr shume kohë. Pra 462 biznese kanë dhënë përgjigje në studim. Ky slide e paraqet një zbërthim të sektoreve prej nga i kemi marr përgjigjet, ku prej 40% janë biznese prodhimi, të tjerat janë tregti me shumicë edhe pakicë 39%, sektori i ndërtimtarisë është 9% dhe sektorët e tjera tutje me përqindje të ndryshme. Vlerësimi fillestar nga bizneset mbi ndikimin e krizës 95% prej tyre kanë vlerësuar se ka ndikim "negativ" apo "shumë negativ". Bile kjo pjesa që e ka vlersuar si "shumë negativ" ka dal me rreth diku 60% nga ai 95%. Siduket masat kanë pasur menjëherë një premje të madhe e cila ka ndiku në këtë vlerësim.

Çka është interesant tek pyetja "si ka ndiku në veprimtarinë e biznesit të juaj", 85.4% e kanë zvogëluar së paku veprimtarinë dhe mbyllja në tërësi është diku afër 40%. Puna me kapacitet të kufizuar kemi mbi 30% e bizneseve dhe ato me orar të shkurtuar me mbi 10%. Kjo faktikisht e tregon edhe një rënie shumë të madhe të menjëhershme të nivelit të aktivitetit biznesor. Në pyetjen se "a e rrezikon mbijetesën biznesi" 61% e respondentëve janë përgjigjur me "po", që është një përgjigje shumë brengosëse duke e ditur edhe likuiditetin shumë të vogël me të cilin operojnë ndërmarrjet në vend. Në pyetjen se "a ka ndikuar COVID-19 në numrin e të punësuarëve tuaj" dhe ajo që është me rëndësi tek kjo pyetje e 6-të është që 30% nga bizneset respondentë prej 462 bizneseve që janë përgjigjur kanë thënë se qysh në kohën e para 10 ditëve kur janë marr këto anketa, numri i të punësuarëve është zvogëluar. Kjo është një e dhënë brengosëse për mendimin tim. Ne jemi munduar pakëz me zberthy edhe në cilat

madhësi të ndërmarrjeve një që e tillë ka ndodh më shumë, duke u munduar që me e bo një analizë “cross-sectional” dhe ndërmarrjet mikro që janë 1-9 të punësuar del që 237 vende pune kanë humbur, në 175 biznese që është jë shkallë prej 27%. Në bizneset e vogla del 23%, të mesëm që janë 50-250 të punësuar, 30% kemi zvogëlim, ndërsa të medhajat me mbi 250 të punësuar me 10% të fuqisë punëtore që është zvogëluar si pasojë e krizës nga këta respondent. Kemi pasur dhe pyetjen për nivelin e tatimeve ku janë përgjigjur vetëm 242 biznese se sa kanë paguar tatime gjatë vitit 2019, vetëm këto 242 ndërmarrje që janë deklaruar janë mbi 223 milion Euro tatime në arkën e shtetit. Pra janë biznese që kanë një rëndësi të madhe në ekonomi. Ka qenë edhe një pyetje se “si e vlerësoni procedurat dhe sjelljen e zyrtarëve për import-eksport” meqë një pjesë e madhe e respondentëve kanë qenë nga sektori i tregtisë dhe përgjigja ka qenë të ngjashme me ato të regjionit. Domethënë nëse flasim për aspektet operacionale kjo është me rëndësi noshta edhe me u lidh me atë se çka tha Guvernatori, kjo nuk është komulative, meqë ka qenë përgjigje “multiple” 75% e bizneseve të anketuara janë deklaruar që kriza po ndikon me humbje financiare, e dyta renditet mungesa e likuiditetit me 44% të bizneseve, që po jep theksin të aspektit financiar dhe është shumë me rëndësi me tentu një bashkëpunim me bankat edhe me akterët tjerë që me u mundu me e nxit likuiditetin në sistem. Unë mendoj se objektivë aktuale e BQK-së duhet qenë që të nxjerrin qat mbi likuiditetin që e kanë në ekonomi. E di që njëra ndër masa lidhet me Fondit Garantues është një mekanizëm i mirë, mirëpo besoj se duhet me tentu me gjetë edhe mekanizma të tjerë se si të nxitet kredi dhënia dhe likuiditeti të del në treg.

Në pyetjen se “si janë afektuar shitjet si pasojë e krizës”, mbi 90% e respondentëve kanë thënë se janë zvogëluar. Ka disa biznese të cilave i është rritur shitja dhe mendoj se kjo është veq një efekt afatshkurtër. Në pyetjen se “sa janë zvogëluar shitjet” 48% e respondentëve kanë zgjedhur masën 75% deri në 100%. Nëse e bëjmë komulative këtë domethënë në 70% të bizneseve shitjet janë përgjysmuar apo edhe më shumë. Kjo është edhe një indikator që tregon se një pjesë e bizneseve do të kenë probleme të mëdha financiare. Shumë shpejtë edhe poashtu tek aspekti i punësimit ku do të ndikoj detyrimisht në zvogëlimin e punësimit, për të cilën duhet me u mendu se çfarë masa mund të mirren në pakon e rimëkëmbjes që mund pastaj të targetojnë përmisimin e kësaj situatë.

Për të mos marr më shumë kohë dua të ndalem tek vetëm edhe disa pyetje. Kur flasim për sa janë të kënaqur respondentët me qartësinë e vendimeve të qeverisë mbi masat kufizuese, shumica kanë qenë të kënaqur apo shumë të kënaqur. Domethënë masat janë pak a shumë të qarta, duke e ditur se ka pasur komunikim të vazhdueshëm edhe përkundër presionit kohor për me i sqaru gjërat relativisht shpejtë. Pyetja se “a jeni të njoftuar me masat ekonomike të qeverisë” shumica dërmuese kanë pohuar se janë të njoftuar mirë me masat të cilat janë parapar. Tek vlerësimi i masave, pjesa më e madhe, mbi 55% kanë pohuar se këto masa i lehtësojnë shumë pak vështirësitë e biznesit. Ministri e tha se këto janë masa emergjente, afatshkurtër dhe mbetet të shihet për pakon e rimëkëmbjes. Një pjesë e madhe e bizneseve sigurisht që do të aplikojnë për ato masa për të cilat ata mund të kualifikohen. Ndoshta nuk kisha me marr më shumë kohë se kaq.

Përveq dy elementeve shtesë që kisha me i përmend, domethënë u përmend që sistemi bankar është shumë likuid, mirëpo një rolë gjithënjë e më të madh viteve të fundit ka pasur edhe sistemi i institucioneve mikrofinanciare. Në bazë të bisedave me klientët tanë në këtë sektor, del se ata tash kanë telashe mjaft të mëdha për shkak të shtyrjes së kësteve dhe pagesave. Këto institucione zakonisht kapitalin e vet, patjetër një pjesë të madhe e nxjerrin si kredi dhe 2/3 në mesatare e kanë prej huamrrjes nga jashtë, e cila sipas informatave për disa prej tyre është rritur në kosto dhe ka filluar të pamundësohet. Prandaj besoj që edhe BQK eventualisht edhe EBRD dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare duhet me pa mundësi se si të mbahet edhe ky sektor likuid. Meqë ky sektor e prekë shumë bujqësinë, këto e kanë rritur huamarrjen në nivel të individëve dhe të bizneseve. Pra ky është një sektor që po preket shumë dhe mendoj që kërkon vemendjen e juaj. Prap efekti i GDP-së do të preket shumë nga ai i remitançave që është 10% - 13%, pra ka hapsirë për një zvogëlim të dukshëm sivjet. Një pjesë e tyre vjen në fakt në sezonin e verës kur diaspora vjen, gjë që tani po duket e pamundur që do të

ndodh sivjet. Prandaj mendoj që edhe në këtë aspekt duhet të përgaditemi për një krizë edhe më të madhe si pasojë e COVID-19 për shkak të zvogëlimit të remitancave si një faktor direkt që e prek konsumin dhe jetesën e përditshme të qytetarëve.  
Faleminderit shumë!

**Lindita Daija:** Bersant, shumë faleminderit edhe Arian për pjesën e parë të prezantimit. Më duhet ta cekë që ndoshta të gjithë ë kuptojne se është shumë me rëndësi që sektori privat të qëndroj në gatishmëri për të qenë krah i qeverisë së Kosovës me informatat e juaja pasi që ju i keni ato direkt nga vet bizneset. Vetëm në këtë mënyrë bashkëpunimi besoj se do t'i ndihmojmë me kohë qeverisë që të merr edhe informatat e juaja në konsiderate për të vazhduar me formulimet e pakos së rimëkëmbjes.

**Bersant Disha:** A mund vetëm edhe një informatë me e jap meqë e kam këtu ne excel. Prej këtyre responentëve që kanë mundin me u përgjigjë në anketën e odave, vende të humbura të punës në qat periudhën e para 10 ditëve, vetëm prej tyre 462 responentëve janë 3, 082 vende pune. Kjo është një mostër, nëse e ekstrapolojmë prej kësaj mundemi me e pa edhe efektin e menjëhershëm që e ka pas në rritje të papunësisë. Kjo është në të gjitha sektoret, përfshir këtu edhe sektorin financiar, jo tek bankat por tek kompanitë e sigurimeve p.sh kemi informata që në muajin prill veq ka vendime për pushimet pa pagesë edhe plane për zvogëlim të stafit. Sigurisht jo me qëllim të keq mirëpo si rezultat i situatës. Këtë deshta ta shtoj vetëm si informatë shtesë meqë nuk ishte në prezantim.

**Lindita Daija:** Faleminderit! Siç thash pavarësisht ne do të vazhdojmë edhe me kontaktet direkte dhe besoj se ajo është një informatë valide. Por deshta të shtoj se është me rëndësi që ju të paktën i prezantuat të gjeturat preliminare dhe shpresoj që do të vazhdoni më tutje me punë në këtë vij dhe do të prezantoni së bashku raportin kur të i vij koha, pastaj të e ndani edhe me të gjithë akterët relevant, së pari me qeverinë dhe pastaj me partnerët tuaj të odave të tjera. Ju faleminderit edhe një herë. Parase të vazhdoj me diskutime sipas kërkesave që është lista në pjesën e bisedimeve apo chat-it, ju lutem dua të ju informoj që prezent e kemi edhe Zëvendësministrin e Ministrisë së Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), z. Edison Jakurti. Prandaj ja kaloj fjalën për disa komente apo pyetje shtesë.

**Edison Jakurti:** Faleminderit shumë znj. Daija. Faleminderit gjithashtu Sekretariatit të KKZHE-së për organizimin e këtij takimit që po mendoj është i domosdoshëm. Faleminderit Ministrit Bislimi dhe Guvernatorit për prezantet ne fillim. Poashtu faleminderit znj. Dobranja për raportet si dhe z. Disha për këtë pyetësor që ishte mjaft informativ.

Une i kamë katër çështje të cilat dua të i përmend dhe që mendoj se janë shumë të rëndësishme. E para ka të bëjë me Pakon Emergjente Fiskale, ku mendoj se është krijuar një hapsirë e vogël e keq interpretimit të kostos së pakos, mbase është dashur qysh në fillim me u shpjegu dallimi në mesë të mënyrës se si bëhet matja e një pakoje fiskale.

Aktualisht mund të them se nuk e dijm koston e pakos emergjente, pra nuk e dijm koston e saj por e dijm koston e kontabilitetit. Për shkak se në koston ekonomik të saj duhet me përfshi edhe koston e mundësisë, ku sipas parashikimeve që na ka jap Ministria e Financave nëse humbjet e Kosovës janë 200 milion Euro, atëhere natyrisht se pakoja nuk është thejstë 180 milion Euro por është 380 milion Euro. Po e them edhe një herë që duhet me prit me i pa humbjet të cilat do të ndodhin në buxhet në mënyrë që me e pa njëmend koston ekonomike, ajo që na intereson neve në këtë rast. Arsyeja pse po e theksoj këtë është se meqenëse nuk është bërë dallimi në mes të këtyre dyjave në çështjen e matjes së pakos, atëhere ka pasur hapsirë edhe për spekulime të ndryshme politike dhe për shuma të ndryshme të cilat jo domosdoshmërishtë përkojnë me situatën dhe vlerën reale të pakos.



Tek çështja e dytë që dua ta adresoj, është se pajtohem plotësisht se është shumë problematike se me kërkim me të matje dhe me çfarëdo shifre që vijm aktualisht, është shumë e guximshme me e përmend sidomos prej institucioneve tona, por megjithatë mendoj se duhet me e bë një mobilizim të të gjitha kapaciteteve teknike që i kemi që të bëjmë sa më shumë matje që mundemi. Po flas për matje “ex-ante” për shkak se në çdo kohë ato duhet me u korrektu. Nëse presim për një matje “ex-post” pas përfundimit të kësaj gjendje dhe të deklarohejm se e dijm me saktësi se sa është ndikimi i krizës, atëherë veq ka me qenë shumë vonë. Prandaj unë plotësisht pajtohem që matja në këtë kohë është shumë problematike por mendoj që gjatë gjithë procesit duhet me u angazhu sa më shumë të gjitha institucionet të cilat kanë kapacitet të matjes për analiza ex-ante, në mënyrë që me pas analiza dhe me pas një pasqyrë të përgjithshme se ka po shkojmë. Ne e dijm përgjithësisht trajektoren e levizjes dhe se cilat e sektor dhe pjesë e ekonomisë po ndikohet, por këto matje ex-ante janë tejet të nevojshme për me pas projekte dhe parashikime për ndërtim politikave, si përgjigje ndaj këtyre dëmeve. Nëse e shohim përgjithësisht se çka po bëjnë vendet e tjera e shohim se janë dy politika kryesore të cilat i marrin, janë politikat fiskale dhe ato monetare. Tek këto fiskale besoj se kemi pasur shumë diskutime me sektorin publik dhe po ka gjithë kohës pyetje drejtuar në Ministrin e Financave. Ndërsa te ky aspekti i politikave monetare unë e kuptoj shumë qartë që Banka Qëndrore e Kosovës është e kufizuar në politika monetare. Megjithatë me mendoj se kishte me pas hapsirë edhe për pak më shumë ndërhyrje në këtë aspekt. Nëse marrim parasysh shifra të cilat janë prezantuar këtu e shohim se bankat janë shumë mirë të kapitalizuara. Do të thotë niveli rregullativ është 12% i kapitalit ndërsa këto kanë 16%. Një gjë e tillë nuk është vetëm në kohë krize, bankat kanë qenë të kapitalizuara ashtu mirë edhe më heret. Por nëse shohim normat e interesit për kredi ato kanë pasur një zvogëlim shumë të ngadalshëm ndër vite. Mendoj se këtu ka hapsirë, natyrisht ky është vlerësimi që duhet të bëjë Banka Qendrore, mirëpo besoj se ka ende hapsirë të ndërhyrjes në mënyrë që kredit të jenë më të lira për ndërmarrjet.

- Pyetja ime në këtë pikë kishte me qenë natyrisht se çka mundet me bo Banka Qendrore dhe a është duke shqyrtuar në këtë drejtim me ndërmarr diqka?

Një çështje tjetër drejtuar BQK-së është, tek rregullimi i sektori bankar a ka ndonjë vendim të fundit ose ndonjë diskutim brenda BQK-së rreth rregullimit të sektorit bankar për shkak se këtu vendimi që është marr në fillim që me u lënë në diskrecionin e bankave me vendos se kush duhet me i kth obligimet brenda afateve të caktuara, emndoj se ka krijuar konfuzion. Duke i parë bankat qendrore të vendeve të tjera besoj se këtu ka më shumë hapsirë për ndërhyrje dhe nga BQK, pra kjo është pyetja e dytë të cilën e parashtrij për Guvernatorin?

Një çështje që e potencoi znj. Dobranja dhe që mendoj se është shumë e rëndësishme dhe që domosdoshmërisht kemi me u përball është sigurisht papunësia por me theks tek dallimi tek papunësia. Ne në Kosovë kemi papunësi strukturore dhe kjo nuk është diqka që do të zgjidhet shpejtë e as lehtë, mirëpo në këtë krizë kemi me pas edhe papunësi ciklike, e cila ka me qenë poashtu problematike, mirëpo pak më e lehtë me u zgjidh se ajo strukturore. Arsyeja pse e them këtë është se ata të cilët e humbin punën për shkak të krizës ekonomike, kta veqse kanë qenë pjesë e tregut dhe është më lehtë me i absorbu tregu. Pra në pakon e rimëkëmbjes duhet pasur parasysh edhe këtë në efektin e ndërhyrjes së shpejtë që është i domosdoshëm tek zvogëlimi i papunësisë ciklike, se sa atë strukturore e cila kërkon më shumë angazhim dhe politika më afatgjatë.

Çështja e fundit të cilën dua ta diskutoj është ajo e cila u përmend tek prezantimi i fundit i z. Disha dhe z. Zeka nga Oda Amerikane. Mendoj se pyetësorët e tillë janë të domosdoshëm në këtë kohë dhe ajo që kish me më interesu dhe po besoj që do të na dërgoni është demografia e mostrës. Për shkak se është shumë me interes me e pa në mënyrë që me e bo këtë lidhjen në mes të pikëpamjeve të ndërmarrjeve mikroekonomike dhe qeverisë makroekonomike, për të pa se sa përfaqësuese është mostra, se sa e pa anshme është mostra dhe cilat janë gabimet në matjet të cilat kanë mundur me u bë gjatë matjes së mostrës. Kjo në mënyrë që me e pa në mënyrë sa më reale me gjendjen që e kemi ne teren. Pra po besoj që te gjitha këto veqse kanë me qenë të përfshiera në raport në momentin që na dërgoni.

Unë po e përfundoj këtu dhe faleminderit edhe një herë për mundësinë.

**Lindita Daija:** Do të ja kaloj fjalën së pari Ministrit të Financave dhe Transfereve dhe pastaj Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Nëse kanë komente apo pyetje rreth këtyre diskutimeve deri më tash.

**Besnik Bislimi:** Atëhere unë shkurtimisht, faleminderit të gjithëve. Edhe unë morra informata shumë të vlefshme sidomos edhe nga prezantimi i Guvernatorit. Megjithëse ne jemi në kontakt të vazhdueshëm edhe Guvernatori është i vetëdijshëm për rëndësinë që e ka institucioni të cilin ai e udhëheqë sidomos gjatë përpilimit të pakos për rimëkëmbje ekonomike sepse ajo pako dominohet nga intervenime monetare, përtej atyre fiskale. Por edhe nga prezantimi i z. Disha i cili tregoi tendin e lëvizjes së punësimit. U tha që deri më sot parashikimi i tij ka qenë që diku rreth 3,000 persona kanë humbur vendim e punës në mostrën më të cilën kanë realizuar këto matje. Gjithashtu tha që kjo mostër është përgjegjëse për afro 200 milion Euro e obligimeve tatimore, që nënkupton një përqindje bukur të madhe të aktiviteti ekonomik në vend. Nëqoftëse kjo extrapolohet me 3 ose 4 në tanësi për me e përmbyll vëllimin e tatimeve që grumbullohet nga bizneset atëhere del që në përgjithësi do të mund të pritët diku një ndikim tek punësimit rreth 12,000 - 13,000. Por prap këto informata duhet me i konsumu me kujdes sepse siç tha edhe Edisoni, demografia e mostrës është kryesore për me e ditë se sa ajo mostër mundet me u përdor për gjeneralizime mbi impaktin total të ekonomisë. Në të njëjtën kohë ka biznese të cilat kanë filluar regjistrimin e punëtorëve. Kemi më shumë se 1,000 punëtor të rinjë që janë në listat e pagave për muajin mars. Që do të thotë duhet të shihet pasaj edhe totalin e ndikimit neto. Parase me e përmbyll unë dy çështje që i ngriti z. Zeka dhe që janë shumë me rëndësi.

1. Trajtimi i përsheptuar i kërkesave, për informatën e juaj deri më sot kanë ardhur kërkesa për kompenzim të 16,000 punëtorëve me mbi 2500 kërkesa dhe diku numri i përgjithëshëm i punëtorëve për të cilët kërkohet kompenzimi është 15,960, pra përafërsisht 16,000 ka ka dikun 850 kontrata me kërkesa për kompenzim të qiras. Për trajtimin e këtyre Ministria e Financave veçse e ka caktuar ekipin apo komisionin. Ky pastaj do të ndahen në tri dhe do të mirren me trajtimin e secilës kërkesë. Ne jemi shumë të bindur që brenda pak ditëve do të bëhet procedimi i mjeteve tek ata të cilët janë të dizajnuar si përfitues. Poashtu javën tjetër fillon edhe procedimi i pagesave për kategorinë të cilët përfitojnë nga masa 1.1 dhe 1.2.

Me pagesat e muajit prill do të ekzekutohen edhe masa 1.6 Do të thotë që so të ketë një likuiditet shtesë në ekonomi, apo stimulus për kërkesën agregate. E di se për bizneset te cilat për vendimet tonë janë mbyllur, ky stimulus nuk ju ndihmon shumë, meqë ato janë mbyllur si pasojë e kërkesave tona.

Por është më rëndësi me e ditë që pozitive remitencat nuk kanë rënë. Guvernatori e cekti shumë më rëndësi edhe këtë informatë dhe pa marr parasysh krizën e cila e atakon një vend ku jeton diaspora duhet me ditë që kriza nëse manifestohet me rënie të profiteve dhe ngjajshme nuk është që ngarkon aq shumë përmasat e remitencave për arsye se pjesa më e madhe e diasporës janë fuqi punëtore. Gjithashtu jetojnë në vendet ku skemat sociale janë bukur shumë të avancuara dhe në rast se ata atakohen nga rënia e vendit të punës ata vazhdojnë të marrin page për 12 muaj, në disa raste si Finlanda edhe më gjatë. Kjo nënkupton që potenciali i tyre për të vazhduar me mbështet familjet në Kosovë me remitencat nuk ka me u zbeh. Unë dhe Guvernatori jemi dakorduar që nuk mund te presim ndonjë goditje të madhe nga remitencat në këtë drejtim. Është diçka tjetër në qoftëse remitencat mundem me godite kur vjen muaji korrik dhe gusht dhe ka brengë që diaspora nuk ka me mujt me ardh në Kosovë, meqenëse një pjesë e madhe e bizneseve me karakter sezonal mbahen nga vizitat e diasporës. Për aq sa e njoh unë diasporën tonë, për shkak që kam jetuar dhe vet për 14 vite jasht, vetëm mjafton me u hap kanalet e udhëtimeve dhe diasporën kemi me e pas këtu.

Pra unë jam pak a shumë ndoshta më optimist se Guvernatori. Në versionin më pesimist kisha me thënë që kemi me u godit me 0 deri në -2% me rënien e GPS. Por prap masat është mirë të mirren nga qëndrimi që ka Guvernatori, meqë nëse nisemi me supozime më pesimiste intervenimi është më i fuqishëm mirëpo tek bizneset është mirë që të shpërndaj optimizëm dhe të themi se ne kemi me u ndiku më pak se regjioni. Unë jam shumë i bindur dhe mund ta përsëris sa herë të ka nevojë, që nuk ka me pas asnjë vend nga Islanda e deri në Bosfor që ka me pas rënien ekonomike më të vogël se Kosova.

2. Edhe një kërkesë që e pati z. Zeka për shtyerjen e raportimeve tatimore. Për momentin unë nuk kam nevojë me ndërhy me vendimmarrje për arsye se raportimet tatimore janë edhe ashtu të shtyera deri në fund të muajit prill. Masat e qeverisë me sa di unë shkojnë deri në fund të muajit prill. Megjithatë ne e kemi trajtuar me stafin e dhe raportimi tatimor bëhet online pra nga shtëpia. Rrjedhimisht bizneset nuk e kanë aq shumë probleme me e kry këto obligim, meqë kryet online. Ajo çka mundemi me e diskutu është që kryerjen e obligimeve sipas këtyre raportimeve mundemi me programu. Mirëpo nuk i ndihmojmë bizneseve domosdoshmërisht nëse themi se e shtyejm raportimin po më shumë i ndihmojmë nëse i themi raportimin kryeni meqë mundeni online. Por të shtyejm obligimet tatimore dhe mudemi me bo riprogramimin. Faleminderi shumë edhe një herë, në qoftë se ka pyetje unë mund të vazhdoj edhe 5 minuta me ju përgjegj nëse ka pyetje.

**Bersant Disha:** Nëse kisha mujt ministër vetëm në lidhje me shtyerjen e pagesave do të thotë të tatimeve. Aktualisht vendimi është që tatimet të paguhen ne fund të prillit nëse nuk gaboj. Mendoj që është shumë me rëndësi për me e rujt likuiditetin e këtyre kompanive që me e shty këtë me të njejtën datë kur edhe u shty raportimi. Pajtohem plotësisht që raportimi mundet me u bo pa problem në çfarëdo kohë dhe nuk ka pasur nevojë me u shty bile, përveq atyre të auditumëve që ka tash telashe me auditim se duhet me u bë në distancë. Por te pagesat qëndron problemi dhe nëse mundet ajo me u shty, besoj se i jep nje hapsirë për frymë shtesë biznesit.

**Lindita Daija:** Faleminderit Bersant. Pasiçë Ministrit Bislimi i duhet të shkoj dhe ju z. Mehmeti do të ju lus për mirëkuptim që bizneset që kanë pyetje për Ministrin t'i drejtojnë tani. Pastaj përfundojmë pjesën e këtij diskutimi me z. Mehmeti.

**Berat Rukiqi:** Linditë a mundem në lidhje me pakon?

**Lindita Daija:** Po

**Berat Rukiqi:** Atëhere ju falenderoj edhe një herë Ministër për prezantimin edhe sqarimet. Ne i kemi vetëm disa pyetje të cilat lidhen me pjesën e implementimit.

- Të vetëpunësuarit domethënë që kanë biznese individuale, domethënë nuk mund të përfitojnë nga këto sepse nuk i kanë bërë vetit kontratë pune dhe funksionojnë si të tillë ka freelancers, apo të ngjashëm të cilët realisht po kërkojnë të përfshihen.
- Tek çështja e likuiditetit në këtë fazë i kemi vetëm ndërmarrjet mikro, e di që ato janë të prekura dhe kanë nevojë për një likuiditet emergjent. Megjithatë, prej hulumtimit e pamë që pak a shumë është një shtrirje e dëmit tek pothuasje të gjitha ndërmarrjet. E kam parasysh që ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha do të trajtohen në fazën e rimëkëmbjes, mirëpo kjo pjesa e likuiditetit është e rëndësishme për të gjithë në momentin kur fillon me u ristartu aktiviteti biznesor.

- Njerën nga pyetjet e bëri Ariani, atë të zbatimit. Por unë e kam një pyetje rreth kohëzgjatjes. Është menduar për dy muaj në varianit ku po mendohet që hapja do të ndodh diku prej muajit maj, apo fillimit të qershorit, por nëse zgjatët Ministër a ka hapsirë që të vazhdoj përkrahja?

Këto ishin pyetjet që kisha ne lidhje me pakon.

**Lindita Daija:** Faleminderit Berat. Unë do të merrja pyetjen edhe na AKB znj. Lumnije Ajdini dhe pastaj Ministri të i përgjigjet të gjithave.

**Lumnije Ajdini:** Në emër të Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) ju faleminderoj shumë i nderuari Ministër Bislimi, për kontributin tuaj që nga fillimi dhe gjatë pandemisë COVID-19. Do të mundohem të flas shkurt që t'ja jap flajën edhe kolegëve të tjerë. AKB-ja që i ka 13,000 anëtar pra jemi dakord që të bëhet shtyerja e pagesës deri me 30 qershor, mirëpo afati i deklarimit është në rregullt të mbetet ai që është. Për arsye se kjo lidhet edhe me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar edhe për shkak të auditimeve edhe pse nuk e dijm ende se çka do të ndodh.

Pyetja e dytë është në lidhje me ankesat që kemi pasur edhe nga bizneset edhe nga punëtorët. Kemi biznese që janë shumë të përgjegjshme dhe kanë pasur likuiditet edhe kanë paguar pa aplikuar për skëma. Mirëpo ka edhe biznese të cilat punëtorëve të tyre për 14 ditë pune që kanë krijuar vlera nuk i kanë paguar për 14 ditë por po e aplikojë masën në vlerën prej 170 Euro. Kjo mandej do të diskriminoj punëtorët e sektorit privat, të cilët veçse kanë qenë të diskriminuar karshi punëtorëve të sektorit publik. Do te kisha kërkuar nga ju që domethënë shtyerja e pagesës për deklarime të jetë së paku deri me 30 qershor. Ndërsa për raportimin ndoshta aty varet edhe prej ecurisë që do të jetë mandej mund të diskutojmë.

Sa i përket planit për rimëkëmbje të ekonomisë ne do të bashkëpunojmë dhe do të ju ofrojmë rekomandime dhe kërkesat nga komuniteti i biznesit do të ju përcjelli me e-mail. Është me rëndësi që në bankat komerciale kemi të deponuara 137 ankesa të bizneseve për arsye, po flas meqë kam marr të drejtën edhe prej disa kompanive të flas në emrin e tyre. E kemi p.sh kompaninë "Ariani" që ju ka kërkuar në aplikimin e shtyerjes për kredi ju ka kërkuar që të paguaj interesin. Nëqoftëse e ka një kredi p.sh 1 milion Euro me 5.5% interes, ju ka kërkuar që së pari ta paguaj interesin në shumë prej 12.056 Euro. Pra cila është mundësia si Ministër i Financave, masi jeni edhe anëtarë në BQK që të keni mundësi të ndihmoni në këtë çështje. Ne e kemi përcjelluar ankesën në fjalë me shkrim edhe tek BQK.

**Lindita Daija:** Faleminderit! E kemi fjalën e fundit. Pasiçë do të vazhdojmë sikur edhe heren e kaluar me një matricë të cilën Ministrja Hajdari është duke e përcjellur tek ministrat e tjerë përkatës. Ju lutem pyetja e fundit edhe nga z. Skender Krasniqi për Ministrin, mundësisht shkurt që Ministri të mund të përgjigjet. Faleminderit për mirëkuptim!

**Skender Krasniqi:** Faleminderit, atëhere unë do të jem shumë i shkurt.

- Është një kërkesë që në mënyrë të rritet punësimi, është kërkesë e kahmotshme lirimi i plotë i lëndës së parë për prodhuesit z. Minister Bislimi sepse një pjesë e madhe e prodhësëve nuk e kanë të liruar. Ka shumë shembuj por kësaj radhe po marrim konret kanqet e aluminit me kod doganor lirohen, ndërsa kanaqet metalike nuk lirohen. Bëhet fjalë për shume produkte të cilat do të ishtë mirë në qoftëse keni mundësi më i pas parasysh, meqë edhe rritet konkurrueshmeria edhe punësimi në këtë kohë.
- Kërkesa tjetër është që shumica e ministrive nuk kanë filluar pagesat e borxheve për vitin 2019, a mund të ekzekutohen ato gjatë këtij muaji? Në këtë mënyrë edhe likuiditeti i kompanive do të jetë më i mirë nëse ka mundësi. Unë kisha vetëm kaq. Faleminderit shumë!

**Lindita Daija:** Faleminderit! Edhe Linda Shala nga G7 ka pyetje.

**Linda Shala:** Përshendetje Ministër. Unë i kam tri qartësime.

- Po ju lutem së bashku me Guvernatorin, Minsitria e Financave dhe Transfereve një takim emergjent me Alenacën e Bankave Komerciale sepse sipas informatave nga terreni kemi një trajtim jo të duhur të bizneseve që kanë të bëjnë me shtyerjen e kredisë. Nuk ka të bëjë me moratorium, nuk është duke u konsideru si moratorium 3 mujor kredit për bizneset dhe individët, por kemi të bëjë me një trajtim ku thu se janë duke marr kredi të reja me afate 3 mujore. Nuk po e zgjas më shumë se e di që jeni të ngarkuar me punë por nevojitet një takim emergjent me bankat me e qartësu mirë qysh janë duke punuar dhe mendoj se duhet me shqyrtu seriozisht zgjatjen e afatit të kredive jo vetëm për 3 muaj.
- Në aplikacionin i cili është vendosur për me apliku për mbështetje është e parapar në pikën 7 edhe mbështetja me 100 Euro të punëtorëve të sektori të cilët kanë punuar gjatë kësaj kohe. Është një kategori të cilën pothuajse 70% e përbëjnë gratë. Momentalisht në aplikacion nuk ka mundësi me u apliku për atë 100 Euro. Prandaj po pyes se kur kanë mundësi me apliku edhe me i marr ato 100 Euro sepse kemi të bëjmë me një kategori të veçantë, të cilën e përfaqësoj unë sot is përfaqësuese e Dhomës së Grave të Kosovës.
- Ju lutem mundësinë me bo moratorium tek përmbaruesi. Mos pagesa e qirave, ka me ndihu që me u aktivizu përmbaruesit dhe mund të ketë një cikël të dëmtimit të mëtutjeshëm të biznesit. Kaq, ju faleminderit.

**Lindita Daija:** Ju falenderoj për mirëkuptim Ministër, fjala është për ju.

**Besnik Bislimi:** kam marr shumë pyetje dhe po shpresoj që nuk do e harroj ndonjëherë.

1. E para për raportimin dhe pagesat, ka të bëjë edhe me ndërhyrjen pyejta e z. Ajdini nga AKB-ja, mirëpo edhe të z.Disha dhe z. Zeka. Arsyeja se pse unë nuk kam marrur vendim ende drejtë shtyerjes së pagesave apo obligimit tatimor është arsyeja se jam duke i përcjellur zhvillimet çdokun ne Evropë dhe këtë javë kanë filluar disa me relaksime të aktiviteteve si Danimarkë, Çeki dhe Austri. Është shumë me rëndësi a ka me vazhdu ky trend edhe nga vendet e tjera apo këto do të kthehen në masat strikte të cilat i kanë pasur deri këto ditë. Kjo pastaj më jep edhe mua një indikacion se a duhet me i shty deri në fund të majit apo deri në fund të qershorit. Nuk është mirë edhe me ju kompliku punën që çdo muaj me e shty për nga një javë. Pra më duhet edhe diku një javë kohë për pak a shumë me e ditë cili është afati më optimal i shtyerjes që as nuk e dëmton biznesin, mirëpo nuk na dëmton edhe neve me implementu pakon për arsye se edhe ne varem nga te hyrat tatimore dhe doganore. Nuk është se nuk e kemi analizuar apo trajtuar, mirëpo nuk e kemi parë akoma të arsyeshme me dal me një vendim.
2. Punëmarrësit individual, ishte pyetje nga z. Rukiqi. Ata kanë me fitu nga skema mirëpo ATK ka parë që duhet me e modifiku formularin për arsye se këta nuk e kanë veten të regjistruar si punëmarrës. Freelancers apo kompanitë që kane të vetpunësuar vetëm veten që kanë paguar kontributet sociale ata përfitojnë nga skema. Vetëmse formulari i tanishëm ka pasur një gabim që nuk ka qenë i dizajnuar për me leju pagesën e tyre.  
E njejtja vlenë edhe për punëdhënësit të cilët i kanë paguar punëtorët e tyre, ka pas me qenë idea që pagesa me i shku punëmarrësit mirëpo tash meqë aty figuron tek pagesat kontoja e punëdhënësit, atëhere nuk ka nevojë për ndërhyrje shtesë por vetëm për sqarim nga ana e punëdhënësit dhe dokumentim që janë kryer pagesat e pagës dhe pastaj kompenzimi shkon tek llogaria e biznesit, përderisa e dokumentojnë se kanë kryer obligimet dhe e dëshmon se ka pasur ndikim negativ të aktivitetit ekonomik. Për mua problemi i madh është me ata punëdhënës të cilët nuk i kanë paguar punëtorët për dy javët e para. Pra gjatë muajit mars punëtorët kanë punuar dy javë, mirëpo qeveria nuk ka thënë se do ta marr përsipër pagën e

muajit mars. Por ka thënë do të ju ndihmoj punëdhënësve në kryerjen e obligimeve të tyre për punëmarrësit. Kjo nënkupton që ne presim që një punëdhënës i përgjegjshëm ta kryej pjesën e tij të obligimit e ne i ndihmojmë me pjesën tjetër. Mirëpo me kthy pagën ose obligimin e tij në zero dhe me prit që qeveria me mbulu edh e angazhimin e punëtorëve për dy javët e para nuk është e sigurtë. Në këtë fazë nuk do të mund ta eliminojmë në tërësi mirëpo të jeni të bindur që mu inbox ne Facebook me mbushet me këso lajmërime dhe këto pastaj mbesin dhe vjen koha kur këto pak a shumë mund t'i adresojmë se cilat biznese kanë keqpërdorur vendimin e qeverisë në dëm të punëtorëve. Ne mendojmë se në këtë situatë fuqia negociuse e punëtorit është shumë e vogël. Rrejdimit punëtori ka nevojë edhe për një mbështetje plotësuese në ato raste që bizneset i tejkalojnë kompetencat e tyre dhe të jeni të bindur se dikush në një moment ka me u marr me këto.

3. Tek pyetjet e z. Krasniqi. Lirimi i lëndës së parë me shembull kontret kanaqet metalike. Ajo që unë kam vërejtur është një lloj kaosi me politikat tarifore ku lirimiet doganore nuk janë bërë për bizneset por për bizneset e caktuara. Në një mënyrë edhe politika e tatimore është implementuar në mënyrë selektive që me i ndihmu disa biznese dhe në dëm të bizneseve tjera. E kam jashtzakonisht shumë problem në këtë fazë ku gjithë energjia po duhet me u drejtu nga pandemia me i bërë edhe korigjimet nëpër margjinë prej gabimeve të cilat janë trashëguar. Por jam i vetëdijshëm dhe e di që ka lirime selektive të cila i favorizojnë biznese të caktuara por jo sektorin e biznesit në tërësi.

Nëse nuk e kam dëgjuar gabimisht pyetja e fundit e juaj z. Krasniqi kishte të bëjë për ministrinë të cilat nuk i kanë kryet obligimet për pagesat. Nëse ka ndonjë pagesë që nuk është kryer ju lutem më lajmëroni mua meqë likuiditeti tek bizneset me kalu sa më shpejtë. Obligimet me u kry në atë moment që na vijin për pagesë. Nuk ka asnjë kërkesë për pagesë nga sektori publik për sektorin privat që ka ardhur në thesar edhe ne e kemi stopu. Mirëpo duhet të shihet se ku është origjina e problemit me na njoftu dhe ne pastaj e shikojmë.

4. Pyetjet e z. Shala. Në atë moment që Guvernatori e sheh të domosdoshme me i ftu Asociacionin e Bankave jeni të bindur që ne do të jemi aty dhe në mbrojtje të këtyre kërkesave që i kemi thënë vazhdimisht. Që mos me apliku kamata në këtë periudhë dhe mos me prek ratingun kreditor të bizneseve. Kjo për ne ka qenë shumë me rëndësi. Në qoftëse bizneset krejt çka bëjnë e shtyjnë kthimin e principalit kur e aplikojnë normën e interesit për mua kjo është një opsion shumë i mirë me i rrit profitet. Nuk është momenti ku sistemi bankar qëndron me rrit profite sepse jeni të bindur që këto profite janë humbje të sektori privat dhe ky sektor është klienti i bankave. Sistemi bankar që mendon me kriju një buxhet afargjatë duhet të mbroj biznesin më shumë se qeveria. Në alternativ qeveria mundet me siguru te hyra edhe përmes qarkullimit ndërkombëtar të mallrave, mund të filloj të shes asetet shtetërore, ndërsa sistemi bankar nuk ka sistem tjetër. Por ka obligime për depozitat e grumbulluara për atë janë të varur nga komuniteti i biznesit edhe një dozë ndoshta më shumë se qeveria duhet me pas interesim që të ruaj kualitetin dhe shëndetin e komunitetit të biznesit si klientin e tij kryesor.

Tash shumica e vendeve të Evropës e kanë aplikuar masën e shtyerjes së kredive për 3 muaj. Nëse situata përkeqësohet, kjo lidhet edhe me pyetjen e z. Rukiqi që tha masat janë për 2 muaj dhe a parashihet rritje e kohëzgjatjes. Në qoftëse kemi thënë duhet me i adresu këto probleme jetike se përndryshe disa shtresa nuk do të mund t'i përballojnë shpenzimet katastrofike etj, tash nuk mundemi me thënë që ata pas 2 muajve do të mund ta përballojnë. Nëse situata vazhdon ne do të jemi të obliguar të vazhdojmë edhe masat. Kështuqë të jeni të bindur se nuk ka qenë kjo "one-off" intervenim sa për të marr ca poena, po ka qenë për me i adresu nevojat. Në qoftëse nevojat vazhdojnë edhe adresimi duhet me vazhdu. Por tash a duhet me u zgjat afati i kredive për 3 muaj apo për 6 muaj, e para është herët me thënë, e dyta mendoj që Guvernatori

është më i thirrur dhe më kompetent me dhënë një përgjigje profesionale. Ndërkaq Zëvendësministri Aliu të cilit ju dasht me shku në takimin tjetër ka punuar gjithë jetën e tij në banka dhe i ka dy mastera në financa dhe 100% gatishmëri me e ndihmu Guvernatorin sa herë që ka nevojë.

5. Pika e 7 e pakos që e përmendi znj. Shala është pikë që edhe unë e kam shumë për zemër. Ndoshta edhe për faktin që e përmendi znj. Shala që mbi proporcionalisht përfitojnë gratë që punojnë drejtëpërdrejtë me klienta. Kemi pranuar shumë pyetje se a e kemi marr parasysh edhe impaktin gjinor të krizës dhe adresimin gjinor të masave. Për mua kjo ka qenë shumë me rëndësi dhe kur e kemi dizajnu masën në tërësi bashkë me ekipën mirëpo edhe me Kryeministrin, jemi munduar në çdo masë me pa sa mundemi me prit që aty do të jenë të përfaqësuara gratë. Kam një binjde bukur te madhe që gratë janë të mbi proporcionalisht të prezantuar në skemë, edhe pse vet masat e qeverisë janë diskriminuese për gratë. Në qoftëse masat thonë duhet një prind me qëndru në shtëpi, ne e dijm mentalitetin tonë dhe e dijm që ai prind ka me qenë 80% gratë. Domethënë në qoftëse paga mesatare në sektorin privat ka me qenë 450 Euro dhe kthehet në 170 Euro, ma shumë kanë me qenë gra që kanë më pas rrogën 170 Euro. Por për me ju përgjigj pyetjes se juaj pika 7 fillimisht ju ka adresuar si institucion MEPTINIST-it. Mirëpo menjher kur kemi fillu me dizajnimin e formularëve e kemi parë që MEPTINISI ndoshta e ka më problem me implementu këtë masë, për shkak të vëllimit të informatave që e ka se sa Administrata Tatimore e Kosovës. Prandaj kemi kërkuar nga ATK që të marr përsipër edhe këtë masë dhe dizajnimin e formularit, për të cilin me sa di është gati dhe këto mjete do të shkojnë më pagën e prillit punëmarrësve. Por është shumë më rëndësi znj. Shala ju me ekipin tuaj me punu fuqishëm që punëdhënësit e këtyre kategorive mos me i përdor këto mjete për me ja ulë benefitet punëtorëve që përfitojnë. Këto janë shtesë, janë nja lloj falenderimi i qeverisë që këta shitës, bukëpjekës, i kanë dalur në ndihmë qytetarëve duke e rreziku sheëndetin e tyre mbi proporcionalisht. Nuk janë të menduara me ja zbut humbjet bizneseve. Sepse përveq furrave që mund të dakordohemi se një pjesë e familjeve gjatë qëndrimit në shtëpi edhe gatuajnë, shitjet e furrave kanë me ra. Mirëpo nuk janë të menduara me ja ulë dëmin bizneseve, janë të menduar me i favorizu ata punëtorë të cilët kanë qenë në vijë të parë tek këto biznese.

Faleminderit shumë edhe një herë, mua po më duhet me e ndërpre por kisha lut Sekretariatit e kuzhës së me e rujt këtë bashkëpunim dhe me na informu. Në qoftëse ka pyetje për mua ndoshta është më mirë me e marr pyetjet te gjitha të kanalizume. E thash dhe në fillim z. Krasniqi më shkruan shumë shpesh, Yllka Metaj më shkruan bukur shpesh, pra faleminderit. Mirëpo kur të më vij të fragmentuara mund të më ikin. Nëse i marr të gjitha të kanalizuara përmes një institucioni sikurse këto attachments që i ka derguar Dita Dobranja edhe për mua është më lehtë me i adresu.

**Lindita Daija:** Faleminderit Ministër Bislimi për kohën. Siç thash në dje e kemi kompeltuar matricën nga takimi i parë, nëse ka nevojë do e bëjmë edhe nga takimi i sotëm një matricë dhe do e adresojmë direkt tek ju. Pasiçë kemi një dinamik dhe tempo shumë të shpejtë ne po mundohemi që të ju ndihmojmë në këtë vij, që të mos merreni individualisht. Gjithashtu po mundohemi me qenë të hapur, jo vetëm për anëtarët por edhe për ata që nuk janë anëtar por të ndërlidhur me situatën tani. Domethënë si me Rrejtin e Shitësve me Pakicë, znj. Yllka Metaj nga RSHP, poashtu me Asociacionin KIMERK, z. Astrit Rexhaj, komentet edhe nga SKAK-u etj.

Ne diskutimet e fundit po i vazhdojmë me z. Mehmeti ku kemi disa diskutime edhe me Bankën Botërore që është tani me radhë si dhe me Forumin Ekonomik të Gruas.

**Besnik Bislimi:** Lindita, më fal vetëm një gjë për fund dua të them. Ekipi që kam këtu afër ne katin e 11-të është fenomenal, kështuqë nijuni të lirë më ju shkru edhe z. Krasniqit edhe z. Ailu, mirëpo edhe shefës së kabinetit Herolëinda Zenuni – Xhulit, sepse edhe ata kanë shumë informata dhe e njohin pakon në detaje dhe munden me ju përgjigj çfarëdo pyetje që keni. Ju faeminderi shumë!

**Lindita Daija:** Faleminderit Ministër Bislimi edhe një herë. Të nderuar unë do t'ja kaloja fjalën z. Fehmi Mehmeti, Guvernatorit të Bankës Qëndrore të Kosovës.

**Fehmi Mehmeti:** Faleminderi edhe një herë. Unë po filloj me konceptin e asaj që po mundohem ta përshkruaj krizën me katër fjalë që janë shuëm të rëndësishme edhe pastaj të kalojmë gradualisht me pyetjet të cilat i keni për t'i parashtruar.

E para koncepti i krizës ekonomike nënkupton rënien e kërkesave që është evidente që ka ndodhur tek ne si rezultat i pandemisë. E dyta ndikon në papunësi masive, që kjo veçse është lajmëru dhe ne e presim që do të rritet. E treta është kriza financiare dhe më pastaj është shtimi i borxhit të shtetit që faktikisht kjo është faza finale. Ne jemi mirë që në të dy fazat e para pritet që kemi dhe ka rënie të kërkesave, papunësi po na duhet ta ruajm sektorin financiar që të mos ketë krizë financiare. Prandaj nëse kemi krizë financiare atëhere kjo ndikon edhe tek shtimi i borxhit të shtetit si fazë e fundit.

- Sa i përket sqarimit të vendimit unë me kryetarët e odave, atë Ekonomike të Kosovës dhe Amerikanë i kam pritur në zyre dhe kam folur shume qartë për vendimin në fjalë. Nuk është çështja në domenin e vendosjes së bankave është vendim që është nxjerr prej Bankës Qëndrore bashkë me Shoqatën e Bankave që jemi kordinuar. Mirëpo është shumë i qartë, bankat duhet të i shtyejn shlyerjën e kredive për 3 muaj duke mos e llogaritur interesin ndëshkues. Njëkohësisht duke mos e prish ratingun e tyre ne regjistrin e kredive. Ne si Bankë Qendrore nuk do të kërkojmë provizione shtesë. Pra do të llogaritet interesi i rregullt, nuk do të paguhet përnjeher interesi i rregullt por interesi i rregullt do të përlllogaritet dhe do të paguhet ne gjasht muajt e ardhshëm. Do të thotë kjo është shume e kjart dhe shumë mirë e kam shpjeguar këtë çështje edhe në takimet që i kemi pasur.

Duhet të keni parasysh një diqka, ne jemi anëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe kemi mbikqyrje, madje rekomandime kemi edhe prej Bankës Qëndrore Evropiane, sa për informatën e juaj një moratorium të tillë Shqipëria e ka marr qysh në fillim, menjher ka reaguuar Banka Qëndrore Evropiane dhe është dashur që të rishikoj të tërë vendimin e saj dhe të vij në suaza të rekomandimeve çfarëe na kanë rekomanduar Banka Qëndrore Evropiane. Prandaj mbi bazën e kësaj në kemi marr në konsideratë edhe rekomandimet çfarëe i marrim edhe nga FMN-ja edhe nga Banka Botërore. Ne jemi nisur mbi bazën e asaj të një moratoriumi që e kanë sot vendët e rajonit, Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera. Prandaj po besoj se sa i përket vendimit po besoj se jam i qartë dhe po qe nevojë mund edhe ta përsëris edhe një herë.

- Sa i përket kompanisë “Ariani” ka ardhur një ankesë edhe tek unë, sa i përket kësaj pagese. Edhe një herë po e them që ndodh që ndonjë analist kreditor me apo pa dije e kalkulon. Mirëpo tw jeni shumë të sigurt, interesi i rregullt do të përlllogaritet apo paguhet vetëm nëse pala don vet me pagu ne fillim është në rregull, nëse jo do të përlllogaritet në gjatë muajt në vijim. Nuk do të ketë interes ndëshkues dhe nuk do të ketë raportim dhe nuk do t'ju prishet gjendja apo ratingu në regjistrimine bizneseve apo të kredive.
- Sa i përket ndërhyrjes së Bankës Qendrore në rastin konkret për me e ulë normën e interesit, unë vetëm një informatë në 2013-ën ka qenë 12.9% norma efektive e intersit ka rënë në 6%. Kemi subvencionim të interesit për sektor të caktuar që i konsiderojmë që kanë promotor të zhvillimit ekonomik, kemi rritje te Fondit, do të ulim rezervat e likuiditetit. Pra t'i detyrojmë bankat që të jepin sa më shumë kredi dhe besoj që kjo do të ndikoj edhe në uljen e normës së interesit. Gjithashtu jemi duke punuar vzhdimisht por ja që panedmi në këtë kohë. Besoj që deri ne maj



ose qershor do ta aprovojmë edhe një rregullore për caktimin e tarifave për produktet bankare bazike qysh e kanë të gjitha vendet. Kemi pasur shumë ankesë sa i përket rritjes së tarifave të shërbimeve dhe jemi duke adoptuar një rregullore për përcaktimin e tarifave bazike që këto produkte bazike si hapjen e llogarisë, mirëmbajtjen etj. Kjo rregullore do të jetë konform se qysh e kanë të rregullume në Gjermani dhe vendet e tjera do ta bëjmë edhe në Kosovë.

Pajtohem plotësisht edhe më atë që tha Ministri që është thënë edhe në raportin e Sekretariatit të KKZHE-së, që struktura e ekonomisë së Kosovës dallon nga struktura ekonomike e vendeve të tjera. Kjo na e bënë më të lehtë që ta tejkalojmë këtë sfidë. U përmend diku në raport që diku 20% tregtia me shumicë dhe pakicë ndikon në GDP edhe që është më pak e prekur, ky sektor ka ndikimin më të madh edhe në numri e të punësuarëve, një tjetër është edhe administrata publike. Pra pa hy në detaje tash duke folur për sektor, unë po besoj që do t'ia dalim më lehtë se sa vendet e tjera. Mirëpo ajo që është me rëndësi ta dijm është fakti që ne sot kemi borxhin e ulët publik që edhe kjo është një parametër shumë i mirë që vendet të cilat kanë borxhin më të vogël publik do ta kalojnë sa më lehtë këtë krizë. Tash nëse ka edhe ndonjë pyetje tjetër dikush më specifike unë jam në pozicionin tuaj sado që ka nevojë.

**Lindita Daija:** Faleminderit z. Mehmeti. Kemi disa diskutime me radhë, znj. Blerta Qerimi nga Banka Botërore. Pastaj znj. Saxhide Mustafa nga Forumi Ekonomik i Gruas.

**Blerta Qerimi:** Faleminderit Lindita. Në fakt unë nuk kam ndonjë pyetje për Guvernatorin, por nëse dikush ka ndonjë pyetje ta parashtrij dhe në fund unë mund të i drejtoj kërkesat e mijja.

**Lindita Daija:** Besoj që ky diskutim do të përfundoj edhe 10 minuta dhe Guvernatori është në rregull sepse kemi vetëm edhe znj. Saxhide pastaj dhe besoj që koha është e mjaftueshme.

**Blerta Qerimi:** Faleminderit shumë, atëhere përshendetje të gjithëve Guvernatorit, zëvendësministrave që janë prezent dhe anëtarëve të KKZHE-së. Faleminderit për mundësinë. Në fakt une kisha një kërkesë dhe një njoftim për ju.

E para ndërlihet me kontributin në aspektin analitik edhe ne kemi në plan duke filluar nga muaji maj ta bëjmë një "business poll survey". Idea është që të bëjmë një anketim online me 1000-1400 biznese. Është një mostër, pra një "sample format" i anketës që është zhvilluar nga ekipa që mirren me hulumtim në kuadër të Bankës Botërore dhe momentalisht jemi duke punuar në përshtatje të saj në formatin e Kosovës. Ashtu si e thanë edhe shumë folës idea është që të kemi një mostër reprezentuese që do të na kishte ndihmu të analizojmë impaktin e krizës në Kosovë. Qëllimi ynë është që ta përsërisim çdo tre muaj, varrësisht edhe nga fondet, që të na ndihmojnë mandej edhe në një fazë të më vonshme.

Çështja e dytë ka të bëjë me një kërkesë që kam për sektorin privat pra shoqata e biznesve. Ju e dini që ne si Bankë Botërore jemi në diskutime me qeverinë për mbështetje të Pakos Emergjente kryesisht për sektorin shëndetësor dhe skema sociale. Sa i përket sektorit privat veprimi ynë i parë është t'i shohim mundësitë e ristrukturimit të projekteve aktuale, në mënyrë që t'i përgjigjemi kërkesave të sektorit privat. Jemi në diskutime me MEPTINIS-in, për ristrukturimin e një projekti të konkureshmërisë në mënyrë që t'i mbështesim bizneset eksportuese dhe t'i ndihmojmë qeverisë me implementimin e masës 13. Në këtë kontekst e kisha një kërkesë që çdo imput që ju keni pasur mundësi ta merrni nga sektori privat për problemet me të cilat ballafaqohen eksportuesit, do të ishim shumë mirënjohës nëse mundeni qoftë përmes Sekretariatit të KKZHE-së qoftë direkt tek ne t'i bartni. Ne mundemi të organizojme edhe diskutime shtesë por idea është që të jemi sa më relevant për kontekstin e Kosovës.

Tjetra është, më duket se e përmendi edhe Ministri, projekti i sektorit financiar i cili, në fakt edhe Guvernatori e përmendi, që mbështet rritjen e kapitalit të Fondit të Garantimit të Kredive që është në parlament momentalisht, që janë 25 milion dollar. Po presim me shpresën që do të aprovohen dhe te ju dalim ne ndihmë sektori privat përmes Fondit të Garantimit të Kredive.

Kaq kisha, ju faleminderit shumë për mundësinë.

**Lindita Daija:** Faleminderit Blertë. Ndërsa z. Mehmeti po i marr edhe komentet e tjera me radhë së pari znj. Saxhide Mustafa nga Forumi i Gruas. Ju lus që nëse mund të jeni të gjithë sa më konciz.

**Saxhide Mustafa:** Përshëndetje të gjithëve po i lë falenderimet që të kursej kohën. Unë po besoj që pasi ka qenë muaji prill për aplikimet e shtyrjës së kredive, besoj që kjo duhet me u zgjat dhe për muajt e ardhshëm duke e pas parasysh për garancionet bankare, që ato mujn me skadu, apo ndoshta ne muajin maj apo qershor, prandaj me ju dhon edhe një mundësi dhe garancione bankare deri ne periudha të muajit të 6-të me u shty për një periudh 3 mujore.

Çështjen tjetër që du me e diskutu ka të bëjë me diskutimin e fundit të pjesës së fjalimit të Guvernatorit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë. Guvernator ky fond është mbet i pa afirmuar sa duhet për mendimin tim, ende nuk e dijn shumë biznese për këtë fond dhe në diskutimet që me znj. Arifi i kam pasur, bakat ende nuk po e prezentojnë apo promovojnë. Ato ende nuk i kanë departamentet ashtu edhe siç është parapar mua po me vjen shumë mirë që ju e prezentuat që ky fond po pritet me u rrit, e edhe mbështetja për kreditim. Po ma merr mendja që ka me qenë një rritje e kërkesës për kredi individuale dhe nga ana e biznesit. Pra ju lus meqenëse banakt përfitojnë nga ky fond të zvogëlohet risku i kreditimit. Ju lus të parashihet një periudh 1 vjeçare, sidomos për bizneset fillestare apo ato prodhuese, që grace periudha të paktën për me mujt me u ngjall. Na e dijm çfarë vështirësish ka shpesh mblidhen nga pagat e të gjithë familjes me u pagu këstet e kredisë, prandaj duhet pasur parasysh edhe këtë periudh me të cilën po ballafaqohemi tash e edhe vitin e ardhshëm besa. Kjo është pak a shumë ajo çka deshta të potencoj.

**Lindita Daija:** Faleminderi Saxhide! Znj. Arjeta Pozhegu e ka një koment dhe znj. Lumnjije Ajdini dhe këto janë finale.

**Arieta Pozhegu:** Përshëndetje. Ne kemi dërguar dje disa propozime apo pyetje në pika të shkurta, ku kemi propozuar që Banka Qëndrore të marr vendim për dhënien e “grace” periudhës deri në 6 muaj për të gjitha bizneset që kanë kredi aktive në të gjitha institucionet financiare në Kosovë dhe të sigruoj që kjo nuk do të shkaktoj përlllogaritje të reja të interesit në institucionet financiare.

- Propozohet që BQK-ja të marr edhe veprime për te inkurajuar edhe institucionet financiare në ofrimin e qasjes më të lehtë në financa për sektorët me theks të veçant tek prodhimi.
- Ndërsa për masat e marrura tashmë nga BQK rekomandohet monitorim i vazhdueshëm nga BQK. Sepse kemi raste ne teren të raportuara me ndryshime apo mënyra të ndryshme të qasjes, të bankave ndaj bizneseve. Meqenëse Kosova ka një borxh publik te vogël në raport me GDP-në krahasuar me vendet ne rajon, ne propozojmë që Kosova duhet te merr apo te ketë parasysh marrjen e një borxhi të jashtëm. Gjithmonë për shkak se është më i levërdishëm që këto biznese te kenë dhe të marrin frymë gjatë periudhës që do të ballafaqohemi pas pandemisë.
- Të përgaditen analiza për industri të cilat kanë ndikim afat-shkurtër në rimëkëmbjen e ekonomisë në Kosovë, ktu i kemi përfshirë industrinë e prodhimit, drurit, mineraleve, plastikës, bujqësisë, teknologjisë informative etj.

TVSH-ja të deklarohet dhe të paguhet në baza 3 mujore prej bizneseve. Domethënë që do të jetë një lehtësim dhe në këtë mënyrë ata do të kenë mundësinë të ruajn likuiditetin.

- Asistenca në sektorin e prodhimit tek bizneset eksportuese, lirimi nga tatimi në fitim në periudha më të gjata.
- Rekomandohet edhe krijimi i një fondi, apo fondi i ringjalljes së prodhuesëve vendor, ku këtu do të përfshihen shumë donator por duhet të inicohet nga qeveria qoftë prej MEPTINIS dhe fondeve nga USAID, GIZ, Banka Botërore, Komisioni Evropian etj. Ky fond do të ishte një rimëkëmbje e prodhuesëve. Kemi bërë një propozim sigurisht se duhet analizuar që nga ky fond të jetë 80% në formë të kredisë pa kamat, ndërsa 20% grant. Një konbinim i cili vazhdimisht nga ky 80% kthehet pas periudhës 1 apo 3 vjeçare, pra të ketë një afat të tillë për bizneset prodhuese sidomos me theks të veçant ato që eksportojnë. Kjo për shkak se industria ka një cikël të prodhimit të blerjes së lëndës së parë, mbajtjes së fuqisë punëtore domethënë gjithë këtë kosto ajo e realizon pas një periudhe në momentin kur e kryen eksportin dhe deri kur sigurohen të ardhurat nga ky eksport. Prandaj kjo periudhë është goxha e gjatë, për atë duhet me u marr parasysh prodhuesi si një faktor i cili duhet të ketë një benefit të veçant në pakot që pritet të dalin gjatë muajve në vijim.

Këto kanë qenë disa kërkesa, të cilat ne jemi duke i shqyrtuar dhe plotësuar edhe me analiza të sektorit mirëpo që do ta ndihmojnë sektorin e prodhimit në rimëkëmbjen. Kaq kisha unë, nuk do e zgjas më shumë, do të mbesim në kontakt dhe do t'i dërgoj të gjitha të shkruara.

Ju faleminderit!

**Lindita Daija:** Faleminderit Arietë. Ja jap fjalën z. Ajdini duke e lutur që të mudohet të adresoj kërkesat sa më shkurt shkaku i kohës.

**Lumnije Ajdini:** Për shkak që kolegët e prezantuan dhe mos t'i bëjë pyetjet e njejta ishte shtyerja e garncioneve bankare. Mirëpo kisha me kërkun nga Guvernatori i BQK-së shumë qartë të na tregoj se kemi shumë raste të kompanive që ju ka loogaritë edhe interesi. Tash çka duhet të veprohet me këto kompani, ku duhet t'i adresojmë edhe pse ne i kemi adresuar edhe tek ju, të cilën e përmendët më heret. Pra si të adresojmë më tutje a duhet të shkohet edhe një herë tek bankat komerciale? Një dukuri e tillë nuk është vetëm tek bizneset por edhe tek kreditë individuale.

Faleminderit.

**Fehmi Mehmeti:** Do të mundohem shkurt nëse më lejohet. Kur flasim për kreditë nënkupton edhe garancionet është e njejtë. Pra beosj në këtë jemi shume të qartë, pra ka shtyerje për kredi, ka shtyerje edhe për garancione.

Për Fondin e Grantimeve fola shumë dhe nuk besoj se ka nevojë të elaboroj më shumë rreth këtij fondi. Megjithatë çka duhet të kemi parasysh gjithmonë edhe që po besoj që nuk jemi duke e marr parasysh, megjithëse i kemi të pranishëm të gjithë akterët edhe odat ekonomike edhe nga ministritë, nuk mund të marrim në zhvillim ekonomik si një hallkë, por si një zingjirë me shumë hallka. Nëse një hallkë shkëputet dhe nuk funksionon atëherë ajo qatë ndërprehet dhe nuk funksionon më. Nga këto hallka njëri prej tyre është sektori bankar dhe sektori financiar. Hallka e parë është rritja e kërkesës, duhet pasur më shumë zhvillim ekonomik, më shumë kërkesa. Pramendoni ne kemi likuiditetin 35%, në anën tjetër kemi përmbi 3.3 miliardë kredi, kryesisht shumica prej tyre janë prej depozitorëve por besoj që pyetja që ishte dasht me u bo tek ne, ishte dasht me pyet se pse kjo rritje kaq e madhe, 16%? Arsyeja është që njerëzit nuk kanë strategji alternative se ku t'i investojnë mjetet dhe i dërgojnë në banka si për më sigurtë. Pra në kushtë normale kishin me pas alternativa ku i kishin investu ato dhe kishin gjeneru profit se sa me i lënë nëpër banka komerciale. Prandaj duhet të ketë zhvillim në ekonomi, në mënyrë që të rriten kërkesat për kredi dhe kjo me automatizën ndikon në uljen e normës së interesit. Në si BQK e kemi për detyrë ruajtjen e stabilitetit financiar, që në këtë rast nënkupton ruajtjen e depozitorëve dhe kredi marrësve, dhe jo mbrojtjen e bankave. Edhe një gjë duhet ta keni parasysh, që me mija lëndë janë

nëpër gjykata të cilat i janë adresuar bankave, ka me vite të tëra. Duhet të krijohet një departament i veçant që do të adresoj zgjidhjen e problemeve të këtyre bankave. Si p.sh ka një numër të madh të atyre që jetojnë në Prishtinë, por edhe vende të tjera ka raste ku e blejnë banesën dhe ajo nuk është në emrin e tyre, dhe dihet se ajo nuk mund të përdoret si kolektar. Problemi është se mungon titullari i pronësisë. Domethënë ka mos punë nga ana e komunave që sot nuk mund të bëhet pranimi teknik. Pastaj ka edhe çështje të tjera që mos të hyjë e t'i përmendi për shkak të kohës. Por arsyeja që po e përmendi është që të shihet edhe zgjidhja e tyre dhe jo të gjitha me u kërku prej bankave. Në rregull unë jam që të aplikohet "grace period". Jam për atë që shumica janë investitor të huaj dhe duhet të rrepektohet se edhe bankat janë të prekura nga kjo krizë.

Sa i përket çështjes së pakos së rimëkëmbjes ekonomike për të cilën ne po pajtohemi që duhet të ekzistoj një pako, për shkak që pasojëat do të përcjellen edhe në vitin e ardhshëm. Përkundër asaj që edhe Banka Botërore edhe Fondi Ndërkombëtar Monetar parashohin që në vitin 2021 në nivel global do të kemi një rritje shumë më të madhe ekonomike, sipas FMN-së dikur prej 7.5% rritje ekonomike pra ne vitin 2021.

Ndonjë pyetje tjetër që mund t'i përgjigjen shpejtë?

**Lindita Daija:** Po, vetëm edhe një pyetje ka z. Krasniqi nga Oda Afariste.

**Skender Krasniqi:** Ju kemi dërguar një kërkesë për rastin e vendeve ku janë të goditura nga COVID-19 dhe si pasojë janë të izoluara. Në rastin e Malishevës p.sh., ju na keni kthyer përgjegje por vetëm deshta me ju njoftu se nuk ka reagim domethënë nga kërkesa e juaj tek bankat që të hapen. Që rrejdhimisht të mund të hapen llogaritë aty.

**Fehmi Mehmeti:** Nëse më lejoni shkurt...në kërkesën që e kam adresuar te bankat e kam përgjellur edhe te ju, dhe kam kërkuar nga ju që nëse keni një fakt të vetëm, pra vetëm na tregoni që ky është fakti dhe ne e adresojmë.

**Skender Krasniqi:** Por asnjë bankë nuk është duke punuar në Malishevë për me pas mundësi dikush me hy dhe me e hap një llogari. Do të thotë mund vetëm të kenë qasjen ne bankomat por jo që të marrin shërbime brenda filialave.

**Fehmi Mehmeti:** Të lutem të keni edhe parasysh që shumë më mirë kish me qenë që edhe ne këtë takim ta kishim mabjtur në një sallë dhe të diskutojmë gjër e gjatë. Kështu jemi të detyruar ta mbajmë në mënyrë virtuale. Ngjashëm edhe ata mund të kryejn shërbimet online, nuk kanë nevojë që të shkojnë dhe të ekspozohen fizikisht. Tash në fuqi janë edhe masat të cilat janë marr edhe prej institucioneve të shëndetësisë. Pra këtë mund ta bëjnë online.

**Skender Krasniqi:** Guvernator, jo të gjithë kanë mundësinë me e hap llogari online.

**Fehmi Mehmeti:** Mirëpo nuk është çështje që mund ta marrim na, ma së pari policia ka caktuar orë kufizuese dhe nuk i lejon as të shkojnë dhe nuk lejohen të ekspozohen fizikisht, ta keni parasysh. Faleminderit shumë të gjithëve.

**Lindita Daija:** z. Guvernatori ishte hera e parë me Sekretariatit e KKZHE-së, ishit shumë bashkëpunues dhe ju falenderoj për kohën dhe që edhe juve nëse kemi lirinë që këto pyetje që ngecin të i mbledhim nga të gjithë dhe t'i dërgojmë tek ju.

**Fehmi Mehmeti:** Linditë, jeni të mirëseardhur edhe në Bankë Qendrore me pyetje apo çfarëdo që keni nevojë për bashkëpunim ne jemi të hapur gjithmonë. Edhe për fund dua te them që ky ka qenë takimi i parë por e kam analizuar në detaje raportin e dërguar. Një raport shumë i mirë, shumë i thukët dhe ju përgëzoj për raportin që e keni bërë. Prandaj dua ta theksoj që jam shumë i interesuar që të kemi bashkëpunim të ngusht me ju si Sekretariat i KKZHE-së.

**Lindita Daija:** Shumë faleminderi z.Mehmeti. Respekt edhe për ju edhe për të gjithë odat. Deri në takimin e radhës ju uroj të gjitha të mirat.

Ju që keni mbetuar akoma dua të ju falenderoj, sepse e kam parasysh që keni edhe takime të tjera. Mirëpo nëse keni edhe diqka ne jemi këtu.

**Lumnije Ajdini:** Nëse mundem shumë shkurt. Linditë kisha me kërku me e inkorporu pra le të shkruhet në procesverbal që Lumnije Ajdini nga Aleanca për Biznese propozon që të inkuadrohet edhe Rrejeti i Shitësve me Pakicë, në të ardhmën. Sepse kjo do të na ndihmoj edhe në vlerësimin e rënies së konsumit. Edhe pse ne jemi të vetëdijshëm të gjithë anëtarët e KKZHE-së si themelues që kërkesa të shkoj në Sekretariat, këta ta përcjellin në qeveri për aprovim dhe pastaj me u kthij dhe të shtohet si anëtar. Mirëpo për hirë të situatës neve ndoshta na duhet të jetë i inkuadruar edhe Rrejeti i Shitësve me Pakicë. E dyta pikë që dua të përmend është se unë do t'ju adresoj juve të gjitha këto pyetje edhe me shkrim tek Fjolla.

Ju uroj një ditë të mbarë dhe ju falenderoj për durimin. E di që edhe ju po i organizoni shumë shpejtë mandej po kemi probleme pse spo jemi në agjendë, mirëpo me të vërtetë kemi shumë probleme dhe tash është krijuar një kaos me të cilën po duhet të mirremi. Për planin e rimëkëmbjes ekonomike ne rekomandimet i kemi dërgu mirëpo këtu na duhet kohë. Po ju njoftoj që ne si AKB jemi duke zhvilluar një anketë me të gjitha sektorët dhe me 1200 biznese, dhe e kemi parashiku që kjo anketë bëhet gjatë muajve mars, prill dhe maj. Pra në fund të qershorit kjo analizë do të jetë e gatshme dhe atëhere do të shohim se cilat kanë qenë të gjeturat e këtij hulumtimi.

Ju falenderoj edhe një herë në emrin e Alenacës dhe ju kisha lut edhe një herë që kur kemi në lidhje me takimet të keni parasysh që ne kemi shumë informacione, si p.sh dje kemi pasur shumë probleme sa i përket formularëve e ATK-së, Ministri nuk e përmendi mirëpo Ministria EPTINIS pardje në ora 23:30 e ka bërë publike listën e orareve dhe të aktivitetve sipas NACE kodeve. Rrejdhimisht deri në orën 9:30 dje jo që ka ra sistemi, mirëpo ATK-ja ka pasur vet probleme si pasojë e dizajnit të formularit që e kanë bërë. Mandej dje janë ndaluar shumë punëtorë të cilët janë ndaluar të gjatë udhëtimit në punë. Pra ka shumë rastë dhe problemi, si këto kompanitë që janë me vendim të ndaluara të ushtrojnë verimin kanë pasur probleme me punëtorët e sigurimit të objekteve. Një shembull tjetër në aktivitetin primar është lejuar në sitemin e ATK-së vetëm ata të shkarkojnë çertifikatën për lëvizje por për të tjerat mandej që ne si Aleancë që tërë ditën të mirremi me rreth 342 rastë ku është dashur të intervenojmë. E falenderoj edhe MEPTINIS-in dje që ka punuar tërë ditën për të korrigjuar listën e NACE kodeve.

Ju faleminderit se e zgjata pak.

**Lindita Daija:** Faleminderit Lumnije, ja kaloj fjalën znj. Saxhide.

**Saxhide Mustafa:** Ju lumtë se po bëni punë të madhe si Sekretariat.

Unë vetëmse i shënova ato që kisha, meqë për shkak kohës u mundova që të flas sa më shkurt. Dhe sapo të përfundoj po ju përcjelli të gjitha përmes e-mailit.

Shëndet juve!

**Lindita Daija:** Faleminderit shumë znj. Saxhide.